



Programi i Trajnimit Fillestar

për prokurorët e sapoemëruar (gjenerata e XII)

2025/2026

Ky program trajnimi është miratuar nga Këshilli Drejtues, i Akademisë së
Drejtësisë me datën 15 tetor 2025



Publikuar nga Akademia e Drejtësisë

© AD 2025, Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij materiali mund të përdoret për qëllime edukative dhe jo-komerciale duke ju referuar AD-së si burim. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi apo çfarëdo forme tjetër e publikimit pa konfirmimin e AD-së.

1. Hyrje	5
2. Synimet kryesore të programit trajnues	6
3. Baza ligjore.....	6
4. Metodologjia e hartimit të programit të trajnimeve	6
5. Struktura dhe përmbajtja e PTF	7
5.1 Synimi për kualifikim.....	7
5.2 Struktura e PTF	7
5.3 Përmbajtja e PTF	10
5.3.1 Pjesa e trajnimit teorik.....	10
5.3.2 Pjesa e trajnimit praktik	11
5.4 Program trajnimi në institucionet jo gjyqësore	11
5.5 Simulimet e gjykimeve	11
6. Vlerësimi.....	12
6.1 Shembull i vlerësimit nga ana e trajnuesit	12
6.2 Formulari i vlerësimit nga ana e Mentorit	13
7. Kalendari dhe orari trajnues	19
8. Kurikula trajnues e trajnimit fillestar për gjeneratën e XII 2025/2026 për prokurorët sapoemëruar	20
9. Kurikula trajnuese për gjeneratën XII (2026 -2027).....	21
9.1 Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar	21
9.1.1 Drejtësia kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial	21
9.1.2 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale	21
9.1.3 E Drejta e Bashkimit Evropian.....	22
9.1.4 Konventa Evropiane për lirit dhe të Drejtat e Njeriut.....	23
9.2 Kodi Penal i Republikës së Kosovës	24
9.2.1 Kodi Penal – Pjesa e përgjithshme	24
9.2.2 Kodi Penal –Pjesa e veçantë.....	24
9.2.3 Krimi kibernetik.....	25
9.2.4 Politika ndëshkimore	25
9.3 Kodi i procedurës penale	26
9.3.1 Kallëzimi penal	26
9.3.2 Masat e veçanta hetimore	26
9.3.3 Fillimi i hetimit formal dhe procedura penale	27
9.3.4 Procedura ankimore dhe vendimmarrja në Prokurorin e Apelit	27
9.3.5 Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale	28
9.3.6 Vendi i ngjarjes dhe forenzika.....	28
9.3.7 Kontrolli dhe konfiskimi	28

9.3.8 Ekspertiza dhe analizat	29
9.3.9 I pandehuri në procedurë penale	29
9.3.10 Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale	30
9.3.11 Procesverbalet	31
9.3.12 Procedurat alternative	31
9.3.13 Administrimi i procedurës penale	31
9.3.14 Provat gjatë hetimit	32
9.3.15 Aktakuza dhe procedura e shqyrtimi	32
9.3.16 Roli i prokurorit në fazat e shqyrtimi gjyqësor	32
9.3.17 Shqyrtimi fillestar dhe shqyrtimi gjyqësor	32
9.3.18 Procedurat e veçanta sipas KPPK	33
9.3.19 Ushtrimi i mjeteve juridike	33
9.4 Shkathtësitë personale dhe nderperesonale	33
9.4.1 Rregullat e komunikimit	33
9.4.2 Etika profesionale dhe përgjegjësia disiplinore	34
9.4.3 Menaxhimi i rasteve dhe vlerësimi i performancës së prokurorëve	34
9.4.4 Ngritja e shkathtësive sociale të prokurorëve dhe menaxhimi i stresit	35
9.4.5 Shkrimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore (akteve akuzuese/ankesave)	35
9.5 Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësues	36
9.5.1 Kodi i drejtësisë për të mitur	36
9.5.2 Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore	36
9.5.3 Ligji për kundërvajtje	36
9.5.4 Dhuna në familje	37
9.5.5 Mbrojtja nga diskriminimi	38
10. Përfundim	38

1. Hyrje

Roli i prokurorit është një ndër shtyllat kryesore të sistemit të drejtësisë. Trajnimi fillestar për prokurorët e rinj nuk është thjesht një proces orientues, por një mekanizëm i domosdoshme për të sigurua cilësinë dhe funksionalitetin e sistemit të drejtësisë. Akademia e Drejtësisë, në kuadër të mandati të saj, organizon trajnimin fillestar për aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapo emëruara. Programi i Trajnimit Fillestar (PTF) është konceptuar si një platformë themelore e përgatitjes profesionale të prokurorëve të rinj, të cilët sapo nisin ushtrimin e funksionit të tyre në kuadër të sistemit të drejtësisë. Objektivi kryesor i programit është ofrimi i një kuadri të strukturuar teorik dhe praktik, mbi bazën e të cilit prokurorët do të zhvillojnë kompetencat e nevojshme për përmbushjen me përgjegjësi të detyrave të tyre kushtetuese dhe ligjore për qëllim zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të tyre.

PTF zgjatë 12 muaj dhe përbëhet nga dy pjesë: pjesa teorik ku trajtohen tema ligjore dhe profesionale përmes trajnimeve, shqyrtimit të rasteve, simulimeve dhe metodave tjera praktike dhe pjesa praktike e cila realizohet në gjykata dhe prokurori ku ata janë emëruar nën mbikëqyrjen e mentorit. Trajnimi Fillestar nuk ka për qëllim vetëm mësimet e ligjit, por edhe zhvillimin e aftësive praktike që u nevojiten prokurorëve gjatë punës profesionale si: hartimi i vendimeve dhe vendimeve procedurale, aftësia për të bërë pyetje, kryesimi i seancave gjyqësore ose kryerja e veprimeve të tjera të dobishme për avancimin e një çështjeje penale ose civile

Njohurit e fituara nga dy pjesët e trajnimit janë të domosdoshme për formimin profesional të paanshëm dhe efikas të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar.

Programi për gjeneratën e dymbëdhjetë të prokurorëve 2025/2026 është gjithëpërfshirës duke filluar nga legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar, hartimi i vendimeve/akteve akuzuese bazuar në analiza të fakteve, aplikim i rregullave etike, zhvillimi i shkathtësive gjyqësore dhe sociale, zhvillimi i kapaciteteve hulumtuese, organizative dhe menaxhuese dhe zhvillimi i shkathtësive inerdisciplinare. Për zbatimin e programit do të përdoret metodologjia e bashkëbisedimit, diskutime të rasteve nga praktika gjyqësore dhe zgjedhjen e tyre nga ana e gjyqtarëve të sapoemëruar, simulime gjykimi etj.

Për zbatimin praktik të këtij programi trajnues hartohen dokumente përcjellëse si: modulet trajnuese, kalendari trajnues, orari i trajnimeve dhe materialet prezantuese për temat konkrete.

Ky program trajnimi është miratuar nga Këshilli Drejtues i AD-së.

2. Synimet kryesore të programit trajnues

Trajnimi gjyqësor është esencial në funksionimin e një sistemi gjyqësor e prokurorial profesional. Në veçanti mjaftë i dobishëm dhe i domosdoshëm vlerësohet edhe trajnimi i prokurorëve të shtetit të sapoemëruar apo trajnimi fillestar siç njihet në terminologjinë e trajnimit gjyqësor dhe konsiderohet si një prej faktorëve kyç në garantimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe kompetencës profesionale e etike të gjyqësorit.

Në programin e trajnimit fillestar për vitin 2025/2026, synimet kryesore janë:

- Ofrimi i një programi trajnimi adekuat për prokurorët fillestar, duke u bazuar në njohuritë ekzistuese të përfituesve;
- Krijimi i një programi trajnues që reflekton kompetencat dhe detyrat në ushtrimin e profesionit të prokurorit;
- Trajnuesit/mentorët të shërbejnë si lehtësues në procesin e mësim-nxënies duke e konsideruar prokurorinë si një institucion edukues;
- Informimi me punën e institucioneve tjera të sistemit të drejtësisë;
- Ofrimi i mundësisë për përfituesin, që duke u angazhuar në punë ekipore, të kryejnë hulumtime për zhvillimin e tyre profesional dhe hulumtime në kontribut të zhvillimit të përgjithshëm të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

3. Baza ligjore

Ligji për Akademinë e Drejtësisë, është ligj bazë për organizimin e trajnimit fillestar. Dispozita tjera që përcaktojnë dhe mbështesin trajnimin fillestar gjenden edhe në ligjet tjera të cilat e rregullojnë funksionimin e sistemit prokurorial.

Me qëllim të zbatimit praktik të këtij programi trajnues AD përveç koordinimit me Këshillin Prokurorial të Kosovës, nxjerrë edhe rregulla të brendshme.

Për këtë qëllim AD bazohet në:

- Ligji për Akademinë e Drejtësisë (Nr. 05/L-095);
- Ligji për Prokurorin e Shtetit (Nr. 08/L-167);
- Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Nr.06/L-056);
- Rregullorja Nr. 01/2024 për Programin e Trajnimit Fillestar;
- Rregullorja për Programin e Trajnimit Fillestar (Nr. 01/2024);
- Rregullorja Nr. 02/2019 - për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë
- Rregullorja Nr. 02/2024 - për Plotësim dhe Ndryshmin e Rregullores Nr 01/2023 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë
- Plani i Punës të AD-së për vitin 2025 (i miratuar nga Këshilli Drejtues i AD-së me datë 18 nëntor 2024);

4. Metodologjia e hartimit të programit të trajnimeve

Për hartimin e këtij programi trajnues janë realizuar disa mekanizma me qëllim të përfitimit të elementeve adekuate për të zhvilluar programin për prokurorët duke filluar nga vlerësimet e trajnimit teorik që përfshin vlerësimet e trajnuesve dhe moduleve në trajnimin teorik si dhe pjesën e trajnimit praktik vlerësimin e zbatimit të trajnimit dhe mentorëve, diskutime me përfaqësuesit kryesor të sistemit gjyqësor e prokurorial, me gjyqtarë, prokurorë, trajnues. Gjithashtu janë bërë vlerësime të raporteve të institucioneve vendore e ndërkombëtare në Kosovë si dhe janë zhvilluar një sërë mekanizmash për vlerësimin e nevojave për trajnime.

Më poshtë janë të prezantuara disa nga hapat e ndërmarrë me qëllim të hartimit të këtij programi:

- Takime me Kryesuesin dhe anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Takim me u.d. Kryeprokurorin e shtetit
- Takim me anëtar të Komisionit për Vlerësim të Performancës për prokurorë
- Realizimi i punëtorisë me grupin e prokurorëve të caktuar për rishikimin dhe përditësimin e programit të trajnimit fillestar për gjeneratën e XI
- Realizimi i punëtorisë me Këshillin Programor;
- Analizimi i strukturës ligjore në fuqi;
- Praktikant e institucioneve ndërkombëtare të trajnimit etj.

Gjithashtu Akademia për gjeneratën e XII ka realizuar proces të vlerësimit të nevojave sa i përket strukturës së trajnimit. Ky vlerësim është realizuar për të identifikuar ndërlidhjen e trajnimit teorik me trajnimin praktik dhe nëse është përmbushë ky objektivi me strukturën aktuale të trajnimit 2 ditë trajnimi teorik në AD dhe 3 ditë tjera trajnim praktik në prokuroritë përkatëse të emërimit pas ndryshimeve të fundit sa i përket marrjes së vendimeve gjatë fazës së trajnimit praktik.

Akademia ka shqyrtuar programin me KKP dhe në bashkëpunim ka adresuar të gjitha ndryshimet e nevojshme.

5. Struktura dhe përmbajtja e PTF

5.1 Synimi për kualifikim

Koncepti i përgjithshëm i synimeve për kualifikim profesional të pjesëmarrësve në PTF është:

- Përmbushja e kërkesave të përgjithshme për funksionin e prokurorit në Kosovë;
- Kompetencat (njohuritë, shkathësitë dhe qëndrimet) e nevojshme për performancë të suksesshme profesionale si prokuror në sistemin gjyqësor në Kosovë;
- Aftësia për t'u përballur me kërkesa dhe sfida që ndryshojnë përherë;
- Aftësia për të përdorur dhe zbatuar kompetencat e kërkuara drejtpërsëdrejti në punë (profesionale, metodike, sociale dhe personale), theks në kompetenca sociale dhe personale reflektim të pavarur për çështje gjyqësore, konsiderimi i procedurave alternative, argumentim bindës;
- Orientim në çështje praktike dhe vetëdijësim mbi ndërlidhjen në mes të dimensioneve juridike, sociale dhe ekonomike;
- Kërkesat për finalizim të suksesshëm (vetë-organizimi dhe disiplina, aftësia për t'u përballur me vëllim të lartë pune);

5.2 Struktura e PTF

Trajnimi fillestar zgjatë dymbëdhjetë (12) muaj. Përcaktimi kohor me ligj mundëson që trajnimi të jetë intensiv dhe struktura e programit të trajnimit fillestar për vitin 2025/2026 është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përfshinë trajnimin teorik i kombinuar me shqyrtime të rasteve nga praktika gjyqësore, simulime etj., ndërsa pjesa e dytë është trajnim praktik i shoqëruar edhe me trajnime në institucione jo gjyqësore që lidhen me punën e prokurorit.

Për të përcaktuar strukturën e trajnimit fillestar duhet përcaktuar fillimisht se cilat kompetenca duhet të zhvillohen tek prokurorët e sapo emëruar, përkatësisht duhet të dimë se cilat janë cilësitë që duhet të t'i ketë një prokurorë.

Për zhvillimin e kompetencave tek pjesëmarrësit e trajnimeve AD bazohet në skemën e mëposhtme:

Integriteti personal dhe sjellja profesionale	• Pavarësia dhe paanshmëria • Vetëbesimi dhe autenticiteti • Angazhim i ndershëm për një gjykim të drejtë	- Është i bindur në lidhje me sistemin ligjor dhe cilësinë e tij; - Përfaqëson vendimin e marrë; - Tregon individualitetin dhe qëndrueshmërinë ndaj ndikimit të veprimeve të veta; - Guxon kur është e nevojshme, për të shkuar kundër pikëpamjeve mbizotëruese; - Është i qartë në lidhje me pritjet, vendos kufijtë.
Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore	• Vendosmëria, marrja e vendimeve gjyqësore • Bindja • Aftësia analitike dhe aftësia për të gjykuar • Përgjegjësia për udhëheqje, • Udhëheqja	- Merr vendime në bazë të të dhënave të disponueshme; - Vepron me vendosmëri edhe kur rritet presioni. - I jep një kuptim të qartë dhe të plotë strukturës së vendimmarrjes dhe procesit të ndjekur në hartimin e vendimeve; - Merr pëlqimin e palëve për vendimin; - I jep kuptim të plotë tekstit të formuluar; - Percepton mundësitë për të sjellë palët së bashku dhe për të ndërmjetësuar në zgjidhjen e kontestit; - Proceson dhe zgjidh një shumëllojshmëri të të dhënave; - Në mënyrë sistematike shqyrton dhe vlerëson; - Bën pyetje në bazë të të kuptuarit; - Diskuton çështje sipas situatave; - Përdor mendime logjike që çojnë në krijimin e deklaratave deri në arsyetim të qartë dhe transparent; - Planifikon dhe organizon punën e vet për rastin; - Përfshinë të tjerët në tema të rëndësishme; - Lejon aty ku është e mundur të tjerët të shtojnë ekspertizën e tyre; - Organizon punën e punonjësve në mënyrë sa më efikase që është e mundur; - Informon të tjerët në lidhje me ecurinë e punës; - Rregullon procedurat (përmbajtja, cilësia dhe përkohshmëria) nëse kërkohet.

Përkushtimi profesional	• Aftësia për menaxhimin e zyrës, • Aftësia për të mësuar dhe vetë-reflektuar • Aftësia për të bashkëpunuar • Fleksibiliteti dhe aftësia për t'u marrë me ngarkesë të punës	- Zhvillon kapacitetet organizative dhe drejtuese, për të kryesuar seancat e marrjes në pyetje dhe për të udhëhequr takime. - Është i hapur për reagime nga të tjerët dhe i përkushtuar ndaj të mësuarit; - Është kurioz, në mënyrë aktive kërkon risi dhe/apo situata të tjera; - I gatshëm për të marrë pjesë në arsimin profesional dhe i angazhuar në trajnime të rregullta, për të rritur kapacitetet profesionale për legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar, - Është i hapur për bashkëpunim me të tjerët; - Merr iniciativë dhe shfrytëzon mundësinë për të ndarë njohuritë, mbështet dhe konsultohet me të tjerët për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e drejtësisë; - Shkëmben praktikën me institucione të lidhura me punën e gjykatave dhe prokurorive;
Ndërgjegjësimi social	• Dëgjimi dhe komunikimi • Përshtatshmëria • Bindja • Ndërgjegjësimi për mjedisin shoqëror	- Tregon mirëkuptim për situatën e të tjerëve dhe kontakton personalisht dhe ka ndjeshmëri për motivim - të dëgjuarit aktiv - jep ndjesinë për të tjerët që kontributi i tyre është pranuar; - Përshtat qasjen e vet, kur situata ndryshon apo kur ajo dikton, përshtatet në rrethana të veçanta dhe situata të ndryshme; - I jep një kuptim të qartë dhe të plotë strukturës së vendimmarrjes dhe procesit të ndjekur në hartimin e vendimeve; - I jep kuptim të plotë tekstit të formuluar; - Percepton mundësitë për të sjellë palët së bashku dhe për të ndërmjetësuar në zgjidhjen e kontestit. - Ka prirje për zhvillimet sociale dhe formon imazhin e vet në kuadër të ligjit; - Kërkon informacione të vjetra, të reja dhe kontradiktore, perspektiva të ndryshme që mund të ndikojnë në vendim dhe procedurë; - Tregon vetëdije për ndikimin e rrethanave të ndryshme dhe të palëve;

- Vlerëson ndikimin e rolit dhe pozitës së tyre në kontekstin social, merr parasysh këtë duke ruajtur distancën;
- Ka njohuri në lidhje me kontekstin socio-ekonomik, në të cilën janë praktikuar funksionet;

PTF është konceptualizuar dhe vënë në kornizë si program kualifikues profesional, i bazuar në kompetenca, i modularizuar dhe i orientuar në vendpune, i cili integron elemente mësimore teorike dhe praktike. Është i disenjuar veçanërisht për zhvillimin profesional fillestar të prokurorëve.

5.3 Përmbajtja e PTF

Përmbajtja e trajnimit fillestar do të fokusohet në zhvillimin e kompetencave profesionale, vlerat etike dhe ndërdisiplinare të prokurorëve të sapoemëruar me theks të veçantë tek:

- Ngritja e kapaciteteve profesionale për legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar;
- Hartimi i vendimeve gjyqësore bazuar në analizë të fakteve;
- Aplikimi i rregullave etike;
- Përshtatja me rrethana dhe situata specifike gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit/prokurorit;
- Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore;
- Zhvillimi i shkathtësive sociale;
- Shkëmbimi i praktikave me institucionet e ndërlidhura me punën e gjykatave dhe prokurorive;
- Zhvillimi i kapaciteteve organizative dhe menaxhuese;
- Zhvillimi i shkathtësive ndërdisiplinare.

Këto kompetenca do të zhvillohen përmes moduleve të cilat janë bashkangjitur si aneks i këtij programi, trajnimit praktik, programeve në institucione jo gjyqësore të ndërlidhur me punën e gjykatave dhe prokurorive si dhe punës praktike që i caktohen nga trajnuesit apo mentorët.

5.3.1 Pjesa e trajnimit teorik

Në këtë pjesë trajnimi zhvillohet në mënyrë teorike i kombinuar me raste nga praktika gjyqësore, bazuar në module trajnuese ku përfshihen trajnime nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive vendore, Acquis Communautaire, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe akte të tjera ndërkombëtare.

Sasia e orëve të punës së programuar për secilin nga modulet të cilët do të realizohen përmes kombinimit me trajnimin praktik, përcaktohet në funksion të:

- Përmbajtjes së modulit trajnues;
- Natyrës dhe vështirësisë së modulit;
- Lloji i modulit dhe rëndësia e tij për praktikën gjyqësore/prokuroriale;

Në përgjithësi programi trajnues i secilit modul përmban të paktën një numër të caktuar të sesioneve trajnuese i realizuar sipas planit të punës. Në kuadër të programit trajnues përveç moduleve profesionale dhe të karakterit ndërdisiplinar përfshihen edhe modulet shtesë të cilat do të realizohen nëpërmjet platformës së mësimi në distancë.

5.3.2 Pjesa e trajnimit praktik

Pjesa e dytë trajnimi praktik zhvillohet në prokurori. Trajnimi realizohet nën mbikëqyrjen e mentorit (prokurorë), i cili është mbikëqyrës për zbatimin e programit trajnues siç është përcaktuar në këtë program dhe doracakun e trajnimeve, si dhe për të bërë vlerësimin e performancës së përfituesit gjatë trajnimit. Programi praktik përfshinë çështje nga aspekti profesional, rregullat e komunikimit, menaxhimin e rasteve, etikën dhe çështje tjera të karakterit praktik me interes për përfituesin.

Programi i trajnimit praktik realizohet mbështetur në “Rregulloren për trajnues dhe mentor si dhe “ Rregulloren për Trajnimin Fillestar” duke specifikuar detyrat dhe përgjegjësitë e mentorëve dhe përfituesve gjatë realizimit të trajnimit praktik. Mentorëve u janë dhënë edhe ide rreth asaj se si t'i ekspozojnë përfituesit ndaj një game të gjerë të temave që do t'i përgatiste ata të marrin detyrat e tyre zyrtare, pas përfundimit të trajnimit fillestar. Fokusi i programit praktikë qëndron tek rëndësia e ofritit të përvojës reale praktike për përfituesit në zhvillimin e aftësive të tyre, duke filluar nga ato profesionale, shkrimi ligjor, të menduarit kritik, etika, rregullat e komunikimit, menaxhimi i rasteve dhe shumë të tjera të karakterit praktik me interes për përfituesit.

Në përfundim të kësaj pjese trajnimi, mentorët bëjnë një vlerësim për përfituesit ku përfshihet, performanca e tyre e përgjithshme gjatë trajnimit, aspekti i punës praktike profesionale, respektimi i orarit, etj.

5.4 Program trajnimi në institucionet jo gjyqësore

Krahas trajnimit praktik nëpër prokurori, prokurorët e shtetit do të ndjekin edhe trajnime në institucione të ndryshme të sistemit të drejtësisë dhe jashtë tyre puna e të cilave është e ndërlidhur me punën e tyre. Kjo do të mundësohet me bashkëpunimin e krijuar në mes të AD-së dhe këtyre institucioneve.

Institucionet në të cilat prokurorët e shtetit të sapoemëruar do të ndjekin trajnime, janë:

- Gjykata Kushtetuese
- Avokati i Popullit
- Policia e Kosovës
- Shërbimi Korrektues
- Shërbimi Sprovues
- Dogana e Kosovës
- Agjencioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- Instituti i Mjekësisë Ligjore

5.5 Simulimet e gjykimeve

Përveç metodave të trajnimit tradicional si diskutime interaktive, studimeve të rasteve praktike, përfituesit e trajnimit fillestar gjatë trajnimit do të përfshihen edhe në simulime të gjykimeve. Simulimi i gjykimeve realizohet përmes përzgjedhjes së rasteve nga praktika gjyqësore nga lëmia penale me përfshirje të elementeve edhe nga fusha tjera të së drejtës. Qëllimi i simulimit të gjykimit është ngitja e aftësive dhe shkathtësive në të shprehur, rritja e vetëbesimit, zhvillimi i mendimit kritik si dhe aftësia për të punuar në ekip. Gjithashtu përmes simulimit të gjykimit pjesëmarrësit mund të përmirësojnë mënyrën e analizimit dhe arsyetimit të fakteve, zhvillojnë shkathtësinë për të dëgjuar dhe bashkëpunuar, të kuptojnë më mirë sistemin gjyqësor, si dhe të avancojnë njohjen e rregullave të të provuarit para trupit gjykues. Në programin trajnues janë planifikuar të realizohen gjithsej 5 simulime.

6. Vlerësimi

Procesi i vlerësimit të përfundimit të suksesshëm të programit trajnues nga prokurorët e sapoemëruar përcaktohet me Rregulloren Nr.1/2024 për Trajnimin Fillestar. Ky proces realizohet por nuk kufizohet vetëm, përmes raportit për vijueshmërinë në trajnim, raportit të trajnuesve, dhe raportit të mentorëve, dhe provimit përfundimtar të cilat përmbledhen në një raport përfundimtarë të përgatitur nga AD, i cili dërgohet në KPK-së në fund të programit trajnues.

Testimet e pjesëmarrësve mund të bëhen sipas këtij sistemi:

- Testimi përfundimtar për PTF përbëhet nga rezultatet e secilit test modular;
- Testimet në module mund të zbatohen në forma të ndryshme: teste me shkrim, teste verbale, elaborime me shkrim, prezantime;
- Parakusht për pjesëmarrje në test modular është pjesëmarrja e rregullt në trajnim.

Vlerësimi gjatë trajnimit teorik do të bëhet bazuar në skemën e lartshënuar që kanë të bëjnë me zhvillimin e kompetencave tek pjesëmarrësit e trajnimeve bazuar në skemën e mëposhtme, ndërsa i gjithë procesi i vlerësimit do të bazohet në kriteret e përcaktuara me ligj për vlerësimin e prokurorëve.

6.1 Shembull i vlerësimit nga ana e trajnuesit

Formular për vlerësim nga ana e trajnuesit për punën praktike apo rastet praktike të pjesëmarrësve në trajnim, përveç vlerësimeve në provime.

Raporti i trajnuesit për rezultatet e vlerësimit për përfundim të modulit trajnues

Emri dhe mbiemri i gjyqtarit/prokurorit të shtetit në PTF:			Moduli Trajnues:		
Identifikimi i fakteve	Njohja dhe zbatimi i ligjit	Analizimi i fakteve	Konkluzioni dhe arsyetimi	Gjuha e përdorur	Vlerësimi i përgjithshëm
Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm
Mjaftueshëm	Mjaftueshëm	Mjaftueshëm	Mjaftueshëm	Mjaftueshëm	Mjaftueshëm
Mirë	Mirë	Mirë	Mirë	Mirë	Mirë
Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë
Shkëlqyeshëm	Shkëlqyeshëm	Shkëlqyeshëm	Shkëlqyeshëm	Shkëlqyeshëm	Shkëlqyeshëm
Komenti i trajnuesit dhe rekomandimet ku përfituesi ka nevojë për përmirësim:					

Data: ____/____/____

Emri & Nënshkrimi i Trajnuesit _____

6.2 Formulari i vlerësimit nga ana e Mentorit

I. KAPACITETI PROFESIONAL PROKURORIAL (KOMPETENCAT TEKNIKE DHE ANALITIKE)

Me kriterin e aftësive profesionale vlerësohen aftësitë profesionale të prokurorit pjesëmarrës të trajnimit në aspektin e njohurive juridike dhe arsytimit ligjor. Ata duhet të kenë njohuri të hollësishme të së drejtës – materiale dhe procedurale. Ata duhet të jenë në gjendje të shkruajnë aktgjykime dhe aktakuza. Ata duhet të përdorin mjetet e TI-së dhe të menaxhojnë informacione nga burime të ndryshme. Kompetencat analitike janë të nevojshme për të përcaktuar informacionin relevant në dokumentet kryesore, për të propozuar/pranuar provat përkatëse dhe për arsyetimin e duhur ligjor dhe vlerësimin e provave.

1. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka njohuri për të drejtën materiale

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

2. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka njohuri për të drejtën procedurale

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

3. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit di të përdorë njohuritë e të drejtës procedurale në praktikë

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

4. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka aftësinë të hartojë aktgjykime, aktakuza, aktgjykime të formës së prerë apo çfarëdo akti tjetër gjyqësor dhe të zbatojë në mënyrën e duhur rregullat ligjore.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

5. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka aftësinë të menaxhojë informacionet nga burime të ndryshme si baza të të dhënave, koleksione legjislative dhe e përdorë TI-në në mënyrë korrekte

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

6. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka aftësinë të përgatisë dhe të zhvillojë hetimet dhe të marrë në pyetje në mënyrë të respektueshme dëshmitarët, të pandehurit, ekspertët, viktimat e krimit.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

7. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka aftësi për të udhëhequr seancat. *(kjo aftësi mund të vlerësohet në një gjykim)*

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

8. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka aftësinë të zhvillojë debatin, të përdorë një gjuhë të qartë, logjike dhe kuptueshme, të shpjegojë pikëpamjet e ndryshme dhe të marrë një qëndrim adekuat. *(kjo aftësi mund të vlerësohet në një gjykim)*

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

9. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit është në gjendje t'i kushtojë vëmendje paraqitjes së fakteve dhe argumenteve ligjore me qëllim që të merr një vendim të arsyeshëm. *(kjo aftësi mund të vlerësohet në një gjykim)*

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

10. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka mësuar të analizojë dhe të përmbledhë një çështje/rast apo dosje.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

11. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka aftësinë të harmonizojë rrethanat dhe hapat e procedurave të një çështje/rasti.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

12. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka aftësinë të formalizoj dhe shpjegojë bazat ligjore të një vendimi dhe të komunikojë qartë dhe në mënyrën e duhur.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

13. Kur merr deklarata ose dëshmi nga dëshmitarët, prokurori pjesëmarrës i trajnimit përdor një gjuhë të qartë, logjike dhe të kuptueshme.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

14. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit tregon aftësi për hetimin strategjik

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

15. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit është në gjendje të nxjerrë një aktgjykim në përputhje me ligjin dhe Kushtetutën.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

II- AFTËSITË ORGANIZATIVE (KOMPETENCAT FUNKSIONALE DHE ORGANIZATIVE) :

Me kriterin e aftësive organizative vlerësohet aftësia e prokurorit pjesëmarrës në trajnim për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të trajtuar procedurat gjyqësore ose hetimore dhe aftësitë për të administruar dosjet gjyqësore. Këto aftësi i referohen kuptimit të organizatave të ndryshme (gjykatave dhe prokurorive të ndryshme), agjendës dhe organizimit efikas të punës.

1. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit e ka kuptuar organizatën ku ai/ajo është caktuar gjatë mentorimit me ju

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

2. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit tregon kapacitet pune dhe aftësi për të zgjidhur çështjet/rastet në aspektin sasior dhe cilësor.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

3. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit është në gjendje të organizojë orarin e tij/saj ditor/javor/mujor në mënyrë efektive.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

4. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka mësuar t'i japë çdo detyrë kohën e nevojshme për ta kryer atë

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

5. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit është në gjendje të analizojë deklaratimet dhe argumentet e ngritura nga palët sipas ligjit në fuqi dhe të nxjerrë një vendim brenda një kohe të arsyeshme.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

6. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit është në gjendje të dëgjojë me gatishmëri dhe me mendje hapur.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

7. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit është në gjendje të ndryshojë mënyrën e punës në cilën ai/ajo punon kur nevojitet dhe të pranojë kritika.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

III. ETIKA DHE PËRKUSHTIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE GJYQËSORE DHE PROKURORIALE

Me kriterin e etikës dhe përkushtimit ndaj vlerave profesionale maten aftësitë e prokurorit për etikën e punës, integritetin dhe paanshmërinë.

1. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit është në gjendje të distancohet nga opinionet e tij/saj personale politike, fetare dhe filozofike dhe nga presioni i jashtëm në kryerjen e detyrave të tij/saj.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

2. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit është në gjendje të mbetet i paanshëm, i pavarur dhe objektiv gjatë tërë kohës kur e ushtron detyrën

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

3. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka aftësinë të menaxhojë situatën konfliktuese dhe të veprojë në mënyrën më të përshtatshme.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

4. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit është i qasshëm dhe shfaq respekt, mirësjellje dhe ndjeshmëri me palët dhe personat e tjerë të përfshirë në gjykatë/prokurori (policia, viktimat, dëshmitarët, punonjësit...)

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

5. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit është në gjendje të tregojë etikë, ndjeshmëri, përlusësi ose autoritet në përputhje me rrethanat.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

IV. KOMPETENCAT SOCIALE DHE PERSONALE

Kompetencat sociale përfshijnë punën në ekip, dëgjimin aktiv, ndjeshmërinë, respektin në komunikim me persona të ndryshëm me të cilët gjyqtari ose prokurori do të duhet të ndërlihet. Kompetencat personale përbëhen nga vlerat kushtetuese që prokurorët duhet të marrin përsipër si parime etike në sjelljen e tyre personale.

1. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit është i aftë të punojë në grup (kjo kompetencë shikohet veçanërisht kur pjesëmarrësi i trajnimit është në prokurori apo në gjykatë, ju mund të përqendroheni në marrëdhënien me ju si gjyqtar)

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

2. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit ndër vepron në mënyrë të përshtatshme me personat e tjerë të përfshirë në gjykatë/prokurori (avokatët, të pandehurit, viktimat, dëshmitarët, policinë)

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

3. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit dëgjon në mënyrë aktive dhe me ndjeshmëri

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

4. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit i kupton pasojat e vendimeve të tij/saj për personat e përfshirë

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

5. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka aftësinë të flasë në publik në mënyrë të qartë dhe lehtëzi. *(kjo aftësi mund të vlerësohet në një gjykim)*

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

6. Prokurori pjesëmarrës i trajnimit ka aftësinë të përdorë një arsyetim logjik dhe të menduarit kritik në ushtrimin e detyrave të tij/saj.

Nuk ka kompetencë					Ka kompetencë të shkëlqyer				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10

7. Kalendari dhe orari trajnues

Për realizmin e këtij programi do të hartohet kalendari i aktiviteteve trajnuese. Trajnimi fillestar mbahet 5 ditë në javë. Pjesa e trajnimit teorik mbahet në Akademi për 6 muaj dhe 6 muaj trajnimi praktik në prokurori dhe i shoqëruar me trajnimet në institucionet tjera jo gjyqësore.

Orari i trajnimeve dhe numri i sesioneve trajnuese është përcaktuar në konsultim të ngushtë edhe me të gjithë aktet relevant.

Kushtet e pjesëmarrjes në trajnim dhe mungesave gjatë trajnimit janë të rregulluara me Rregulloren për Trajnimin Fillestar.

8. Kurikula trajnues e trajnimit fillestar për gjeneratën e XII 2025/2026 për prokurorët sapoemëruar

Programi trajnues për prokurorë të sapo emëruar gjenerata e XII				
Nr.	Kurikula trajnues	Orë trajnimi	Moduli trajnues	Nr. i sesioneve
1.	Rendi juridik kombëtarë dhe ndërkombëtarë	69 orë	1.1 Drejtësia kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial	2
			1.2 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile	4
			1.3 E drejta e BE-së	7
			1.4 KEDNJ- legjislacioni për të Drejtat e Njeriut	9
2.	Kodi Penal i Republikës së Kosovës	105 orë	2.1 Kodi Penal i Kosovës – pjesa e përgjithshme	14
			2.2 Kodi Penal i Kosovës – pjesa e veçantë	13
			2.3 Krimi kibernetikë	4
			2.4 Politika ndëshkimore	4
3.	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës	303 orë	3.1 Kallëzimi penal	3
			3.2 Masat e veqanta hetimore	7
			3.3 Fillimi i hetimit formal dhe procedura penale	3
			3.4 Procedura ankimore dhe vendimmarrja në Prokurorin e Apelit	2
			3.5 Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë	6
			3.6 Vendi i ngjarjes dhe forenzika	5
			3.7 Kontrolli dhe konfiskimi	4
			3.8 Ekspertiza dhe analiza	6
			3.9 I pandehuri në procedurën penale	3
			3.10 Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale	9
			3.11 Procesverbalet	3
			3.12 Procedurat alternative	6
			3.13 Administrimi i procedurës penale	4
			3.14 Provat gjatë hetimit	9
			3.15 Aktakuza dhe procedura e shqyrtimit	7
			3.16 Roli i prokurorit në fazat e shqyrtimit gjyqësor	7
			3.17 Shqyrtimi fillestar dhe shqyrtimi gjyqësor	8

			3.18 Procedurat e veçanta sipas KPPK-së	3
			3.19 Ushtrimi i mjeteve juridike	6
4.	Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare	81 orë	4.1 Rregullat e Komunikimit	2
			4.2 Etikë profesionale dhe përgjegjësia disiplinore	8
			4.3 Menaxhimi i rasteve dhe matja e Performancës	9
			4.4 Ngritja e shkathtësive sociale të gjyqtarëve e prokurorëve dhe menaxhimi i stresit	4
			4.5 Shkrimi dhe arsyetimi i vendimeve/akteve akuzuese/ankesave	6
5.	Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese	48 orë	5.1 Kodi i Drejtësisë për të Mitur	2
			5.2 Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore	8
			5.3 Ligji për kundërvajtje	2
			5.4 Dhuna në familje	2
			5.5 Mbrojtja nga diskriminimi	2

9. Kurikula trajnuese për gjeneratën XII (2026 -2027)

9.1 Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar

9.1.1 Drejtësia kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokuroial

Në këtë modul do të trajtohet kuadri normativ për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, burimet kushtetuese në Kosovë, kompetencat e Gjykatës Kushtetuese dhe procedura në këtë Gjykatë veçmas procedura e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë. Gjithashtu objekt trajtimi do të jenë edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, natyrë juridike, llojet, efekti si dhe mënyra e përmbarimit të tyre. Krejt kjo e shoqëruar me raste nga praktika e Gjykatës Kushtetues të Kosovës. Si parashihet edhe me Kushtetutë dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, gjyqësia kushtetuese vepron vetëm në një instancë dhe ndaj vendimeve të saja nuk mund të apelohej asnjë ankesë ose mjet tjetër juridik i rregullt ose i jashtëzakonshëm. Vendimet e gjykatave kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës andaj edhe shtrohet nevoja e trajtimit të tyre të gjithanshëm.

Ky modul do të trajtoj: Burimet e së drejtës kushtetuese dhe roli i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, procedura në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe vendimet e saja. Adresimi i çështjeve që janë me rëndësi për prokurorët e sapo emëruar nga tematika e përmendur do të bëhet përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u ndërlidh me rastet praktike.

Kohëzgjatja: 2 sesione trajnuese (12 orë trajnimi).

9.1.2 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar paraqitet si mënyrë për të ofruar dhe marrë ndihmë juridike ndërkombëtare ndërmjet gjykatave, prokurorive dhe autoriteteve tjera kompetente vendore dhe të huaja.

Në këtë drejtim, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale paraqitet si nevojë në këto kohë moderne meqë krimi i ka tejkaluar kufijtë e brendshëm dhe ka marrë dimension

ndërkombëtar. Në këtë botë gjithnjë e më të ndërvarur, asnjë vend nuk mund të luftoj krimin në mënyrë efektive pa bashkëpunim mes shteteve për të parandaluar dhe për të zbuluar krimin. Kështu që është e një rëndësie të madhe aftësia e shteteve për të ndihmuar njëri-tjetrin shpejt dhe në mënyrë efikase. Përderisa, kur flitet për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale mendohet në çdo formë të ndihmës së kërkuar apo e ofruar nga një shtet tjetër, organizatë apo institucion, me qëllim të mbështetjes së procedurave penale në çështjet si: (ekstradimi, transferimi i procedurës penale nga shtetet e huaja në Republikën e Kosovës, transferimi i personave të dënuar nga shtetet tjera në Republikën e Kosovës, njohja dhe ekzekutimi i aktgjykimeve të huaja në Republikën e Kosovës, kërkesat vendore për ndihmë juridike të ndërsjellë të drejtuar shtetit tjetër dhe paraqitja e dëshmitarëve, ekspertëve dhe të pandehurve etj). Ndërsa kur flitet për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në lëminë civile, flitet vetëm për dhënien dhe marrjen e ndihmës juridike ndërkombëtare në çështjet civile dhe komerciale, duke përjashtuar çështjet e tatimeve, doganave ose administrative, e as në ato të përgjegjësisë së shtetit për veprimet ose mos veprimet në ushtrimin e autoritetit shtetëror. Ndërsa njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore dhe të arbitrazhit rregullohet me Ligjin për të drejtën ndërkombëtare private dhe nuk hyn në domenin e ligjit për ndihmë juridike ndërkombëtare në çështjet civile. Në gjykata dhe prokurori çdo ditë e më tepër po paraqiten raste nga më të ndryshme duke filluar nga dhënia e ndihmës minimale juridike - akt lutjet e ndryshme për marrjen e deklaratës së dëshmitarëve apo dorëzimin e dokumenteve/ftesave apo aktvendimeve të ndryshme e deri tek ekstradimi i të kërkuarve sipas akt lutjes së shtetit kërkuar. Adresimi i dilemave në praktikë që janë me rëndësi për prokurorët e sapo emëruar nga tematika e përmendur do të bëhet përmes shpjegimit të pjesshëm teorik të nocioneve themelore që përmbajnë dispozitat ligjore në fuqi nacionale dhe ato ndërkombëtare, ky modul trajnuet do të trajtoj në tri sesione bashkëpunimin juridik në çështje penale dhe një sesion në lëmin civile.

Kohëzgjatja: 4 sesione trajnuese (12 orë trajnimi)

9.1.3 E Drejta e Bashkimit Evropian

Me këtë nën modul synohet trajtimi i çështjeve dhe ofrimi i njohurive për prokurorët e sapo emëruar të Republikës së Kosovës mbi efektin e të drejtës së Bashkimit Evropian. Gjithashtu fokusi do të jetë edhe në analizën e aspekteve të zbatimit të parimeve të së drejtës së BE-së para anëtarësimit në BE me theks pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim-Asocim. Si do të zbërthehet efekti i së drejtës së BE-së pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim-Asocim?

Republika e Kosovës si vend i rrethit juridik-evropian aktualisht është në fazën e procesit integruar evropian ku pos adoptimit të legjislacionit me standardet e BE-së (aqe komunitare) rëndësi po i kushton reformave në sistemin gjyqësor e veçmas asaj të përgatitjes së prokurorëve të sapo emëruar me njohurit e së drejtës evropiane dhe procedurat që zhvillohen në institucionet gjegjëse të Unionit Evropian.

Në këtë modul do të trajtohen proceset integruese (qoftë në aspektin e integriteteve të thelluara gjithashtu edhe atyre të zgjerimit) si dhe në mënyrë më të detajuar origjina e BE-së; familjarizimi me institucionet e Bashkimit Evropian, roli dhe përgjegjësia e tyre, natyra e kompetencave të BE-së; njohja në themel e të drejtës së BE-së (struktura e Traktatit të Bashkimit Evropian, objektivat dhe vlerat e Bashkimit Evropian) njohja me krijimin e së drejtës së BE-së, raporti i kësaj të drejte me atë nacionale dhe ndërkombëtare si dhe procedurat e shqyrtimit gjyqësorë. Gjithashtu do të trajtohen vështirësitë dhe dilemat që lidhen me interpretimin e efektit të së drejtës evropiane në nivel nacional (efekti i drejtpërdrejt dhe i tërthortë) si dhe zbatimi i kësaj të drejte nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim – Asocimin.

Adresimi i dilemave në praktikë që janë me rëndësi për gjyqtarët e sapo emëruar nga tematika e përmendur do të bëhet përmes shpjegimit të institucioneve të Bashkimit Evropian, rolit dhe përgjegjësisë së tyre, sqarimit të kompetencave të BE-së; njohjes me të drejtën e BE-së, dhe raportin e kësaj të drejte me atë nacionale dhe ndërkombëtare si dhe përmes zbërthimit të

procedurave të shqyrtimit gjyqësorë veçmas ato që zhvillohen në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE).

Në zhvillimin e këtij moduli ndër metodat që do të përdoren do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive në grupe të ndara, të cilët do të mbrojnë dhe argumentojnë qëndrime të ndryshme dhe analizë të rasteve gjyqësore. Gjithashtu synohet edhe realizimi i një pjesëmarrjeje aktive të pjesëmarrësve, në mënyrë që edhe ata të kontribuojnë në realizimin e objektivave të modulit.

Ky modul do të trajtoj: Rendin juridik të BE-së, instrumentet, karakteristikat dhe parimet themelore të së drejtës së BE-së, organizimi gjyqësor i BE-së, gjykata e Drejtësisë e BE-së dhe roli i gjykatave nacionale, bashkëpunimi mes gjykatave nacionale dhe gjykata e drejtësisë e Bashkimit Evropian për vendosjen preliminare si dhe mbrojtja e të drejtave themelore në Evropë.

Kohëzgjatja: 7 sesione trajnuese (21 orë trajnuese).

9.1.4 Konventa Evropiane për lirit dhe të Drejtat e Njeriut

Konventa Evropiane për lirit dhe të Drejtat e Njeriut si instrument ndërkombëtar i përmbajtur në Kushtetutën e Kosovës, është edhe pjesë përbërëse e rendit juridik të Kosovës. Interpretimi dhe zbatimi i normave ligjore nacionale sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe sipas kuptimit të KEDNJ në Republikën e Kosovës bëhet në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Përkundër që Republika e Kosovës ende nuk është palë kontraktuese në këtë Konventë, e njëjta, është bërë pjesë përbërëse e rendit juridik të Kosovës me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ashtu që të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara në Konventë zbatohen drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës, ndërsa interpretimi i lirive dhe të drejtave themelore të përcaktuara me Kushtetutë, bëhet në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Andaj, adresimi i dilemave në praktikë që janë me rëndësi për prokurorët e sapo emëruar nga tematika e përmendur do të bëhet përmes shtjellimit të nocioneve themelore të të drejtave dhe lirive që burojnë nga kjo Konventë, shpjegimit të efektit juridik të KEDNJ-së në legjislacionin e Kosovës, elaborimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të interpretimeve që bënë ajo, me theks të veçantë sa i përket: Të drejtës për liri dhe siguri (neni 5); Të drejtës për një proces të rregullt (neni 6); Të drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8); Të drejtës në lirit të shprehjes, përfshirë edhe çështjet që ndërlidhen me mbrojtjen e gazetareve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve (neni 10). Gjithashtu përmes diskutimeve interaktive në grupe të ndara të pjesëmarrësve, të cilët do të mbrojnë dhe argumentojnë qëndrime të ndryshme dhe analizë të rasteve gjyqësore nga GJEDNJ. Me këtë modul synohet edhe realizimi i një qasjeje pro-aktive të pjesëmarrësve.

Kohëzgjatja: 9 sesione trajnuese (27 orë trajnimi).

9.2 Kodi Penal i Republikës së Kosovës

9.2.1 Kodi Penal – Pjesa e përgjithshme

Pjesa e përgjithshme e Kodit penal është pjesa më e rëndësishme materiale penale. Në këtë pjesë do të trajtohen dhe shpjegohen dispozitat që kanë të bëjnë me parimet bazë të ligjit penal material. Mbi këto premisa synohet që të kuptohen dhe avancohen shkathtësitë e prokurorëve të sapo emëruar për zbatimin e ligjit më të favorshëm, kuptimit të veprës penale dhe format e përgjegjësisë penale, shkaqet e përjashtimit të përgjegjësisë penale, format e bashkëpunimit kriminal, llojet e sanksioneve penale që përcakton kodi penal dhe mënyra e aplikimit të tyre në praktikë. Parashkrimi si institut shumë i rëndësishëm, rehabilitim ligjor dhe zbatimi i legjislacionit penal në kuptim të hapësirës së efektit dhe të mbrojtjes së të mirave juridike të vendit. E thënë më thjeshtë kuptimi dhe mundësia e aplikimit të dispozitave të pjesës së përgjithshme në praktikë nga prokurorët e riijnë do të lehtësonte jashtëzakonisht shumë zbatimin e pjesës së posaçme të kodit penal si dhe veprat penale të veçanta në sistemin juridik të vendit. Në këtë trajnim do të fokusohet aspekti i interpretimit të këtyre dispozitave duke bërë si fokus primarë aplikimin e dispozitave të tilla në rastet praktike të punës, e duke i analizuar në kontekst me elementet e veprës konkrete penale që do të merrej si rast praktik. Do të synohet që implementimi i pjesës së përgjithshme të kodit penal të aplikohet mbi bazën e rastit që ngrit dilema që kanë të bëjnë me pjesën e dispozitave të përgjithshme, në mënyrë që prokurorët e sapo emëruar të kuptojnë më së miri se si duhet të i qasen aplikimit të kësaj pjesë të Kodit penal në punën e tyre. Rëndësi vendimtare do të jenë trajtimi i dilemave që paraqiten në praktikën e formave të fajësisë që tërheqin edhe përgjegjësinë penale. Pastaj kuptimi i dashjes, pakujdesia, dijenia, dhe qëllimi që janë në vazhdimësi me dilema në praktikën gjyqësore posaçërisht prokurorët e riijnë që i hasin. Sanksionet dhe mënyra e implementimit, që shpërfaqin dilema për disa nga sanksionet se a mundet gjyqtari pa propozim të prokurorit të shqiptoj disa nga dënimet plotësuese. Pra do të implementohet kjo pjesë në kontekstin e praktikës dhe problemeve që hasen në praktikë. Kjo pjesë do të përfshijë dispozitat më të rëndësishme të pjesës së përgjithshme të kodit si në vijim: elementet e veprës penale, veprat penale dhe përgjegjësia penale, përgjegjësia e personave juridik, format e fajit (dashja, pakujdesia dhe lajthimi), shkaqet që përjashtojnë përgjegjësinë (mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, dhuna dhe kanosja), bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale (Bashkëkryerja, shtytja, ndihma, bashkimi kriminal, marrëveshja për të kryer veprën penale, sanksionet penale – llojet e dënimeve (dënimet kryesore, plotësuese, alternative dhe vërejtja gjyqësore), masat e trajtimit të detyrueshëm dhe pasojat juridike të dënimit, rehabilitimi i të dënuarave dhe parashkrimi.

Kohëzgjatja: 14 sesione trajnimi (42 orë trajnimi)

9.2.2 Kodi Penal –Pjesa e veçantë

Duke pasur parasysh vëllimin e veprave penale që përmban pjesa e veçantë e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, gjatë trajnimit do të synohet që pjesëmarrësit të njoftohen, me veprat penale që kanë rëndësinë më të madhe që në momentin e parë kur fillojnë prokurorët e sapoemëruar me punën e tyre në prokurori, pra do të fokusohet në veprat penale që bien në kompetencën e trajtimit të lëndëve nga prokurorët fillestar dhe me theks të veçantë ato vepra që janë më të shpeshta në praktikë por duke mos anashkaluar edhe veprat që në praktikë nuk kryhen shpesh. Pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të njoftohen me disa vepra penale të disa kapitujve veç e veç, elementet e veprave penale si dhe kush mund të jetë kryerës i veprave penale. Gjithashtu do të njoftohen se cilat vepra penale kryhen me dashje dhe rastet kur kryhen nga pakujdesia. Do të kuptojnë po ashtu elementet dalluese tek vepra penale e formës së kualifikuar në raport me kualifikimin bazë të secilës vepër që do të trajtohet. Do të synohet që ndërtimi i qasjes të bëhet përmes metodave të kombinuara të aspektit interpretues dhe aplikimit në rastet praktike. Sqarimet më të nevojshme të problemeve praktike që konsistojnë në problemet e përgjithshme në aplikimin e normave, duke filluar me të kuptuarit e elementeve të veçanta se si përmbushen ato në secilin rast me secilën vepër që do të trajtohet, duke ndërtuar rastin në atë mënyrë me shpërfaqjen e dilemave të praktikës në punë për

të arritur që të kuptohet se si duhet eliminuar ato dilema në mënyrë që të mos ketë aplikim jo të drejtë të normës konkrete që inkriminon veprën konkrete penale. Nga pjesa e posaçme do të përfshihen disa vepra penale që janë në kompetencë të prokurorët fillestar dhe po ashtu do të trajtohen me theks të veçantë veprat që më së shumti shpërfaqen në praktike, si në vijim: Veprat penale kundër jetës dhe trupit, veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, veprat penale kundër të drejtave në marrëdhënien e punës, veprat penale kundër integritetit seksual, veprat penale kundër martesës dhe familjes, veprat penale kundër shëndetit publik dhe veprat penale kundër narkotikeve, veprat penale kundër ekonomisë dhe korrupsioni, veprat penale kundër pasurisë, veprat penale kundër rendi publike, veprat penale kundër mjedisit, veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë, veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme në trafikun publik, dhe veprat penale kundër administrimit të drejtësisë.

Kohëzgjatja: 13 sesione (39 orë trajnimi).

9.2.3 Krimi kibernetik

Përvoja e sugjeron se në shumicën e rasteve, gjyqtarët dhe prokurorët hasin vështirësi në përballje me realitetet e reja të botës kibernetike. Për këtë arsye, kërkohen përpjekje të posaçme për ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve që të mund të ndjekin ligjërisht dhe gjykojnë krimin kibernetikë dhe të shfrytëzojnë provat elektronike nëpërmjet trajnimit, lidhjes në rrjet dhe specializimit. Ky nën modul është hartuar për t'i pajisur prokurorët me një nivel bazë të njohurive në lidhje me krimin kibernetikë dhe provat elektronike. Kursi do të ofrojë informacion praktik po ashtu edhe ligjor në lidhje me temën dhe do të përqendrohet sesi këto çështje ndikojnë në punën e përditshme të prokurorëve. Ky modul do të përmbajë udhëzime dhe instrumente të bashkëpunimit ndërkombëtar, të cilat mund të përdoren gjatë hetimit të çështjeve të krimit kibernetikë, duke përfshirë përdorimin 24/7 të pikave të kontaktit, MLA, Aktivitetin e Bashkëpunimit Gjyqësor, Platformat e Bashkëpunimit Gjyqësor, etj. Në këtë modul do të trajtohen provat elektronike, sigurimi dhe marrja e tyre në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetikë si dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Do të trajtohen po do të trajtohen veprat penale të krimit kibernetikë dhe procedura e ndjekjes.

Kohëzgjatja: 4 sesione trajnuese apo (18 orë trajnimi).

9.2.4 Politika ndëshkimore

Politika ndëshkimore ka paraqitur sfidë të vazhdueshme për të gjithë akterët e drejtësisë penale dhe padyshim se në këtë aspekt një rol të rëndësishëm në këtë proces kanë edhe prokurorët e shtetit të cilët përmes funksioneve të tyre kanë ndikim edhe në harmonizimin e politikës ndëshkimore. Padyshim se pas përcaktimit të fajësisë, caktimi i dënimit, përkatësisht përcaktimi i rrethanave lehtësuese dhe rënduese është aspekt i rëndësishëm e cila ka impakt të drejtpërdrejtë në shqiptimin e dënimeve konsistente dhe të cilat do të kenë ndikim në trajtimin e barabartë dhe do të ndikojnë në ngritjen e besimit në sistemin gjyqësor. Përgjithësisht duke identifikuar probleme të theksuara dhe trajtim të pabarabartë i kryerësve të veprave penale dhe mos konsistencë në shqiptimin e dënimeve dhe kjo ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e transparencës dhe besimin e publikut. Me qëllim të adresimit të këtyre problemeve është parë e nevojshme të hartohet dhe miratohet një dokument i cili do të kishte për qëllim harmonizimin e politikës ndëshkimore dhe arritjen e konsistencës së dënimeve kryerësve të veprave penale dhe për këtë arsye, Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerr udhëzuesin për politikën ndëshkimore dhe tabelën për caktimin e dënimit. Njëkohësisht është formuar Komisioni Konsultativ për Politikë Ndëshkimore e që anëtar i saj është përfaqësuesi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe i cili Komision në vazhdimësi përcjellë dukuritë dhe sfidat që gjyqtarët dhe prokurorët përballen me rastin e zbatimit të udhëzuesit për politikën ndëshkimore dhe gjatë punës së tij në vazhdimësi nxjerr udhëzime specifike përkitazi me harmonizimin e politikës ndëshkimore dhe të cilat do të prezantohen dhe diskutohen gjatë këtyre tryezave që planifikohen të organizohen. Aspekti i politikës ndëshkimore del të mos jetë problem vetëm i gjyqësorit, por edhe i Prokurorisë e që për këtë arsye është nxjerrë Udhëzim mbi Rolin

dhe Kontributin e Prokurorit të Shtetit në Matjen e Dënimit me synim të qartësisë dhe shpjegimin e rolit të prokurorit gjatë të gjitha fazave të procedurës penale në përgatitjen, mbledhjen e informacioneve, marrjen e të dhënave relevante nga i pandehuri dhe viktimat dhe prezantimin me sukses para gjykatës. Një rol të rëndësishëm prokurori i shtetit e ka edhe të seanca për matjen e dënimit duke siguruar të dhëna të rëndësishme të cilat janë relevante për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si çështje e rëndësishme në këtë modul trajnues dalin të jenë zbatimi i Udhëzuesit të përgjithshëm dhe udhëzuesve specifik, përcaktimi i rrethanave lehtësuese dhe rënduese nga prizmi i prokurorit të shtetit dhe roli i prokurorit të shtetit gjatë seancave gjyqësore e posaçërisht në seancën për caktimin e dënimit duke prezantuar të dhëna relevante përkitazi me të kaluarën e të pandehurit, pasurinë e tij dhe argumentimin e këtyre rrethanave me qëllim të shqiptimit të dënimit adekuat kryerësit të veprës penale.

Kohëzgjatja: 4 sesione trajnuese (12 orë trajnimi).

9.3 Kodi i procedurës penale

9.3.1 Kallëzimi penal

Kallëzimi penal është një akt joformal dhe referuar rëndësisë që ka ky akt për fillimin e procedurës penale, përmes këtij nën moduli dhe gjatë trajnimit, synohet që pjesëmarrësit të njoftohen me kallëzimin penal në përgjithësi, personat që mund ta ushtrojnë atë, kush është autoriteti kompetent për trajtimin e tij dhe kallëzimi penal kundër personave të panjohur. Në këtë modul do të trajtohen autorizimet e policisë para parashtrimit të kallëzimit penal dhe pas ngritjes së tij, po ashtu do t'u prezantohet edhe kallëzimi penal nga organet tjera shtetërore, nga qytetarët etj. Vëmendje të veçantë do ti kushtohet edhe veprimeve të prokurorit të shtetit me rastin e pranimin të kallëzimit penal, kërkesa për sigurimin e të dhënave plotësuese të kallëzimit penal, ndërmarrja e veprimeve të caktuara hetimore dhe raporti i veçantë. Në përmbajtje të këtij moduli do të diskutohen edhe pasojat e kallëzimit të rremë, përkatësisht veprën penale lajmërimi apo kallëzimi i rremë, kur kryhet ajo, rrethanat kur përjashtohet përgjegjësia penale, hetimi i rastit me vetë iniciativë. Me theks të posaçëm do të trajtohet aktvendimi për hedhjen e kallëzimit penal, bazat për marrjen e këtij vendimi dhe si detyrë do të kërkohet edhe përpilimi i një vendimi të tillë.

Kohëzgjatja: 3 sesione trajnimi (9 orë trajnimi)

9.3.2 Masat e veçanta hetimore

Këto masa janë përpjekje të ligjvënësive për të forcuar mundësinë për hetimin, ndjekjen dhe luftimin sa më efikas të kriminalitetit por nga ana tjetër janë masat me të cilat po që se nga zbatuesit e ligjit nuk ndërmerren në suazat e përcaktuara ligjore, ekziston mundësia reale të shkelen dhe cenohen edhe të drejtat dhe liritë elementare të njeriut, prandaj duhet të zbatohen me kujdes dhe përpikëri që sa më pak të cenohen të drejtat e njeriut të cilat janë garantuara me akte vendore dhe ndërkombëtare. Për këtë qëllim me KPP janë përcaktuar kushte strikte në aplikimin dhe lëshimin e këtyre masave. Qëllimi i zbatimit të këtyre masave është parandalimi i kryerjes së veprave penale, zbulimi efikas i veprave penale, si dhe ndjekja e kryesve të tyre për rastet kur nuk mund të zbulohen me veprime tjera hetimore. Në kuadër të këtij moduli do të trajtohet përkufizimet e masave të veçanta, parimet dhe standardet ndërkombëtare për zbatim të masave dhe pranueshmëria e provave të siguruar me anë të urdhrave për masat e veçanta hetimore, procedura për nxjerrjen e urdhrave për masa të veçanta hetimore dhe afatet, zgjatja dhe ripërtëritja e urdhrave për masat e veçanta hetimore. Gjatë trajtimit të modulit do të prezantohen rastet praktike që janë trajtuar dhe pjesëmarrësve, gjatë ushtrimeve do t'u jepet mundësia e përpilimit të kërkesave për lëshimin e këtyre masave.

Kohëzgjatja: 7 sesione trajnimi (21 orë trajnimi).

9.3.3 Fillimi i hetimit formal dhe procedura penale

Ndryshimet e shumta ligjore, nga pas lufta duke përfshirë edhe Kodin e procedurës penale, sidomos mbi rolin e prokurorit të shtetit i cili ka fituar një dinamizëm më të madh në raport me kodet e kaluara, ngase ka kompetenca më të mëdha gjatë kryerjes së detyrave të tij duke qenë aktivë në çdo fazë të procedurës penale, me rol të dyfishtë si përfaqësues i shtetit dhe palë në procedurë penale. Me rritjen e autorizimeve të prokurorit të shtetit, tani edhe procedura penale, duhet kuptuar si luftë mes dy subjekteve të barabarta, për çka gjykata duhet të qëndrojë në mes në rolin e arbitrit, ku detyrat e gjyqtarit të procedurës paraprake koncentrohen më shumë në rastet e kufizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, lëshimi i masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, sekuestrimi dhe konfiskimi etj. Bazuar edhe në parimin akuzator nemo iudex sine actore ndjekja penale është kompetencë ekskluzive e prokurorit të shtetit, prandaj edhe roli i tij është i një rëndësie të posaçme, ashtu që i mundësohet të orientoj procedurën hetimore nga fillimi i saj, duke udhëhequr hetimet dhe bashkëpunuar me policinë me rastin e mbledhjes dhe sigurimit të provave. Në këtë nën modul do të përfshihet procedura para hetimore, autorizimet e prokurorit të shtetit pas pranimit të kallëzimit penal, fillimi i hetimeve, pezullimi i hetimeve, kushtet për nxjerrjen e këtij akti, rifillimi i hetimeve, pushimi i hetimeve dhe kushtet për nxjerrjen e këtij akti. Pjesëmarrësve do t'u jepet mundësia që nëpërmes ushtrimeve që do të aplikohen gjatë trajnimit të përpilojnë aktet e përshkruara në këtë trajnim.

Kohëzgjatja: 3 sesione trajnimi (9 orë trajnimi).

9.3.4 Procedura ankimore dhe vendimmarrja në Prokurorin e Apelit

Kodi i procedurës penale në kapitullin e IX nënkapitulli II, neni 84 par. 5, ka përcaktuar llojin e mjetit juridik (ankesa) i cili mund të përdoret nga pala e dëmtuar apo viktimë, kundër aktvendimit mbi hedhjen e kallëzimit penal apo aktvendimit mbi pushimin e hetimit. Sipas këtij kodi pala e dëmtuar apo viktimë e pakënaqur me vendimin e prokurorit të shtetit mbi hedhjen e kallëzimit penal apo pushimin e hetimit mund të ushtroj ankesë në prokurorinë e apelit, përmes prokurorisë kompetente e cila e ka nxjerr atë vendim. Ushtrimi i ankesës ka efekt supenziv pra nuk është i plotfuqishëm dhe devolutiv ngase vendosa instanca më e lartë. Qëllimi i mjetit juridik (ankesës) është evitimi i të metave juridike apo faktike që pretendohet se janë bërë nga prokuroria përkatëse. Në kuptim të dispozitave të KPP-së i dëmtuari apo viktimë gjithashtu mund të ushtroj ankesë të drejtpërdrejtë në prokurorinë e apelit për dështimin e prokurorit të shtetit në PTH/PSRK që të ndërmerr veprime hetimore apo procedurale, brenda afatit ligjor. Në përmbajtje të këtij moduli dhe gjatë trajnimit do të synohet që pjesëmarrësit të njoftohen me procedurën e ushtrimit të mjetit juridik (ankesës), kundër aktvendimit mbi hedhjen e kallëzimit penal apo aktvendimit mbi pushimin e hetimit, duke përfshirë palën kompetente dhe afatin ligjor për të ushtruar ankesën si dhe cfarë duhet të përmbajë ankesa. Gjithashtu pjesëmarrësit do të njoftohen me vendimet e prokurorisë së apelit lidhur me ankesën e ushtruar dhe afatin në vendimmarrje. Në këtë modul do të trajtohen: hartimi i aktvendimit mbi aprovimin apo refuzimin e ankesës, aktvendimit mbi hedhjen e ankesës si të pasafatshme apo të palejuar dhe aktvendimit mbi aprovimin apo refuzimin e ankesës për dështimin e prokurorit të shtetit në PTH/PSRK, që të ndërmerr veprime brenda afatit ligjor. Rëndësia e këtij moduli qëndron në efektin që paraqet hedhja e kallëzimit penal apo pushimi i hetimit dhe qëllimin që arrihet me paraqitjen e ankesës. Gjithashtu në krijimin e një standardi unik të vendimmarrjes për të gjitha prokuroritë si në kuptim të ndërmarrjes së veprimeve procedurale dhe hetimore ashtu edhe në kuptim të vlerësimit dhe analizimit të provave, pretendimeve faktike dhe cilësimit juridik.

Kohëzgjatja: 2 sesione trajnimi (6 orë trajnimi)

9.3.5 Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale

Me qëllim të zbatimit të procedurës penale, në frymën e standardeve të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe akteve tjera, sipas Kodit të procedurës penale, është e nevojshme prania e të pandehurit në procedurën penale. Referuar kësaj KPPRK-ja ka paraparë nëntë masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale. Përmes këtij moduli synohet që pjesëmarrësit të njoftohen me llojet e këtyre masave, zbatimin e tyre në praktikë, kohëzgjatjen e tyre, autoritetin kompetentë që kërkon caktimin e këtyre masave dhe atë që e urdhëron, përmbajtjen e kërkesës për këto masa dhe kushtet në detaje për caktimin e tyre. Duke marrë parasysh se si masë më e rëndë për nga ashpërsia është paraburgimi dhe sipas akteve ndërkombëtare por edhe sipas legjislacionit vendor kërkohet që paraburgimi të aplikohet vetëm kur me masa tjera si alternativa të saj nuk mund të arrihet qëllimi sipas KPPRK-së, një sesion i veçantë i është lënë masës së paraburgimit. Referuar edhe faktit se në praktikë këto masa sidomos paraburgimi ka vështirësi në arsyetimin e bazave për caktimin e tij dhe për tu qasur dhe adresuar këto dilema në praktikë, prokurorët e sapo emëruar përveç prezantimit të materialeve dhe rasteve praktike do të diskutojnë edhe raste nga praktika duke shprehur mendimet e tyre. Gjithashtu do të ushtrohet edhe një rast praktik përkitazi me këtë masë dhe do të shpjegohen në detaje kushtet për lëshimin e kësaj mase dhe standardet që duhet përdorur në kërkesën e prokurorit për këtë masë. Ky modul do të trajtoj këtë përmbajtje: Thirrja, urdhërarresti dhe premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi i të pandehurit për t'iu afruar vendit të caktuar dhe personave të caktuar, obligimi i të pandehurit për paraqitjen më të afërt në stacionin policor dhe dorëzania, arresti shtëpiak dhe paraburgimi.

Kohëzgjatja: 6 sesione trajnimi (18 orë trajnimi).

9.3.6 Vendi i ngjarjes dhe forenzika

Këqyrja e vendit të ngjarjes bëhet menjëherë pas kryerjes së veprës penale me qëllim të zbulimit dhe konservimit të gjurmëve të veprës penale të cilat janë ende të freskëta dhe qëllimi i saj është që në mënyrë të drejtpërdrejt të vërtetohen saktë dhe sa më objektivisht rrethanat materiale të cilat kanë të bëjnë me veprën penale. Ndërsa rikonstruimi i vendit të ngjarjes urdhërohet pas kalimit të një kohe të konsiderueshme nga momenti i kryerjes së veprës penale dhe zbatohet me krijimin e fakteve ose të situatave nën rrethanat e të cilave është kryer vepra penale, bazuar në provat e mbledhura. Si këqyrjen ashtu edhe rikonstruimin, varësisht prej fazës së procedurës penale mund t'i urdhëroj edhe prokurori i çështjes. Qëllimi i këtij moduli trajnimi është që prokurorëve të sapo emëruar t'i ndihmoj lidhur me hapat fillestarë nga momenti i pranimi të njoftimit për kryerjen e ndonjë veprë penale, veprimet urgjente që duhet ndërmarrë, bashkëpunimi me policinë, kushtet për dalje në vend ngjarje dhe rikonstruim, personat që duhet ftuar, autoriteti kompetent për lëshimin e këtyre veprimeve, dallimi mes këqyrjes dhe rikonstruimit, momenti adekuat i zbatimit të rikonstruimit, përpilimi i procesverbalit të vendit të ngjarjes. Në fund do të realizohet një simulim – Këqyrja në vendin e ngjarjes duke bërë simulimin e këtij instituti.

Kohëzgjatja: 5 sesione trajnimi (15 orë trajnimi)

9.3.7 Kontrolli dhe konfiskimi

Mjeti më efikas në luftimin e kriminalitetit pa dyshim që është instituti i konfiskimit dhe shtetet të cilat kanë treguar rezultate në këtë drejtim janë pikërisht ato të cilat e kanë trajtuar me seriozitet këtë institut procedural. Në këtë modul do të trajtohen dispozitat të cilat rregullojnë këtë materie si ato vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare. Gjatë trajnimit prokurorët e sapoemëruar do të njoftohen me urdhrin për kufizim të përkohshëm, kërkesën për sekuestrim të përkohshëm, kërkesën për masa të përkohshme për sigurimin e pasurisë, urdhri ndalues, kërkesa për urdhrin ndalues afatgjatë, përmbajtje e këtyre akteve, kohëzgjatja e tyre, kushtet për lëshimin e tyre, personat kompetent të cilët i lëshojnë dhe të drejtat e palëve. Gjithashtu do të shtjellojnë ligjin për

kompetencat e zgjeruara të konfiskimit dhe do të trajtojnë raste nga praktika vendore dhe ndërkombëtare.

Kohëzgjatja: 4 sesione trajnimi (12 orë trajnimi).

9.3.8 Ekspertiza dhe analizat

Në rastet kur para organit të procedimit dalin çështje për të cilat nevojitet njohuri e posaçme në fushat e ndryshme të shkencës vije në shprehje ekspertiza, e cila ndihmon për të vërtetuar apo vlerësuar ndonjë fakt të rëndësishëm kur duhet të sigurohet qëndrim dhe mendim nga personi që ka dijen e nevojshme profesionale. Shumë fakte do të kishin mbetur të pandriçuara në procedurën penale, po të mos ishte pranuar si provë në procedurë penale edhe ekspertiza. Të arriturat shkencore, sidomos përdorimi i këtyre arriturave në kryerjen e aktiviteteve kriminale pashmangshëm ka vë në pah obligimin për përdorimin e këtyre metodave bashkëkohore si provë në procedurë penale përmes përpilimit të ekspertizave të caktuara. Në këto raste përmes ekspertizës mund të ndihmohet që të zbulohet përgjegjësia penale e të pandehurit. Në këtë modul do të trajtohen: dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë materie, llojet e ekspertizave, personat kompetent për lëshimin e tyre, detyrimet e ekspertit, raporti i tij dhe deklarata, të drejtat e palëve në raport me ekspertimin dhe vlera provuese e raportit të ekspertimit dhe deklaratës së ekspertit. Fokusi i këtij moduli do të qëndroj tek zbatimi në praktikë i këtyre instituteve procedurale dhe do të kenë edhe ushtrime nga rastet praktike.

Kohëzgjatja: 6 sesione trajnimi (18 orë trajnimi).

9.3.9 I pandehuri në procedurë penale

I pandehuri është njëri ndër subjektet kryesore në procedurën penale. Në legjislacionin tonë penal i pandehuri përveç detyrimeve ai gëzon edhe një sërë të drejtash të cilat duhet respektuar dhe zbatuar nga organet e ndjekjes dhe gjykata, sepse pavarësisht faktit se në legjislacion janë përcaktuar shprehimisht të drejtat e të pandehurit në procedurë penale, në praktikë ndeshen një sërë problematikash, për sa i përket respektimit të tyre. Referuar legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtar, në veçanti Konventës Evropiane mbi të drejtat e njeriut, i pandehuri ka të drejtë që ndaj tij të zhvillohet një gjykim i drejtë dhe i paanshëm, të jetë i barabartë më palët në gjykim dhe të respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë. Për të qenë në nivelet e standardeve europiane, nga organet e zbatimit të ligjit, kërkohet që të kenë prioritet respektimin e integritetit dhe personalitetit të të pandehurit, duke i garantuar atij të drejtat që i njeh Kodi i Procedurës Penale.

Meqenëse një nga parimet bazë dhe themelore të shtetit të së drejtës, është respektimi i lirive dhe të drejtave të individit, trajtimi i të drejtave të të pandehurit në procedurë penale, kërkon që të njihet mirë konteksti i këtyre të drejtave dhe fusha e zbatimit të tyre. Respektimi me rigorozitet i të drejtave të të pandehurit kërkon një vëmendje të veçantë në vendin tonë, në kohën kur legjislacioni penal dhe procedural penal, përpiket të harmonizohet me normat ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë. Bazuar në praktikën gjyqësore është e nevojshme që të trajtohet efikasiteti i instrumenteve mbrojtëse në favor të të pandehurit dhe respektimi në praktikë i të drejtave të tyre. Që të realizohet ky trajtim në aspektin e respektimit të të drejtave, duhen parë të drejtat e të pandehurve në planin e legjislacionit të brendshëm si dhe në aktet ndërkombëtare që i trajtojnë gjerësisht këto të drejta. Qëllimi i këtij moduli ka të bëjë me faktin se deri në çfarë shkalle legjislacioni ynë garanton mbrojtjen e këtyre të drejtave. Nisur nga ajo që u theksua, qëllim i këtij moduli është evidentimi i të drejtave dhe detyrimeve të të pandehurit që janë parashikuar më Kodin e Procedurës Penale, për të parë së sa realisht respektohen të drejtat e të pandehurit. Është e rëndësishme të kuptohet se një shtetas, kushdo qoftë, që ka marrë cilësinë e personit nën hetim ose të të pandehurit, nuk është thjesht një subjekt procedural që duhet të trajtohet ftohtë nga sistemi i drejtësisë. Përkundrazi, figura e tij duhet të shihet në kompleksitet, në mënyrë që atij t'i bëhen të njohura mjetet ligjore që i garanton ligji, si dhe duke respektuar të drejtat e tij gjatë kryerjes së veprimtarisë hetimore e gjyqësore. Gjatë realizimit të këtij nën moduli qasja do të jetë interaktive, duke u dhënë mundësi prokurorëve të sapo emëruar që të paraqesin dhe diskutojnë të gjitha dilemat

që kanë në praktikë dhe për të nxjerr konkluzione dhe rekomandime për tejkalimin e këtyre dilemave. Gjatë prezantimit të këtij moduli do të paraqiten raste kur një person mund të trajtohet si i pandehur, cilat janë dallimet e shprehjeve “i dyshuar”, “i pandehur”, “i akuzuar” dhe “i dënuar”. Prezantimi do t’u ofroj mundësi pjesëmarrësve të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e të pandehurit gjatë procedurës penale, nga fillimi deri në përfundim të procedurës. Në këtë modul pjesa e ushtrimit do të zbatohet duke ju ofruar pjesëmarrësve shembuj nga praktika përkitazi me pozitën e të pandehurit në faza të ndryshme të procedurës në mënyrë që pjesëmarrësit përmes diskutimeve të identifikojnë së për cilën fazë të procedurës është fjala, duke e identifikuar pozitën e të pandehurit me fazën konkrete të procedurës. Pjesëmarrësve do tu mundësohet qasja në raste praktike, ku mund të shihen sukseset dhe dështimet në rastin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të dëmtuarve, si dhe në rastet e dëshmitarëve bashkëpunues.

Kohëzgjatja: 3 sesione trajnimi (9 orë trajnimi).

9.3.10 Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale

Një ndër provat e rëndësishme që shërben për të vërtetuar një gjendje faktike në mënyrë të plotë dhe e drejtë në një çështje penale është edhe dëshmia e dëshmitarit dhe të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit. Dëshmitar si rregull mund të jetë çdo person i cili mund të jep njoftime për veprën penale, për kryesin e veprës penale dhe për rrethanat e rëndësishme për procedurën penale. Meqenëse çdo rregull ka edhe përjashtim edhe të dëshmitarët vlen një parim i tillë, sepse ka raste kur një person edhe pse mund të jep njoftime për veprën penale, për kryesin e veprës penale dhe për rrethanat e rëndësishme për procedurën penale, ai nuk mund të jetë dëshmitar për shkak se më dëshminë e tij mund të zbuloj sekretin zyrtar apo ushtarak. Pastaj në rastin kur është i bashkëpandehur në procedurën e përbashkët dhe mbrojtësi për atë që i ka besuar i pandehuri në cilësinë e mbrojtësit. Përveç kësaj ka edhe dëshmitar të cilët për shkak të afërsisë që kanë më të pandehurin apo për shkak të një pozite që kanë në shoqëri janë të liruar nga dëshmia. Gjithashtu në raste të caktuara në procedurën penale mund të ketë edhe persona që kanë kryer vepra penale por që dëshirojnë të bashkëpunojnë me prokurorin dhe nëse prokurori ka ndonjë interes për procedurën penale mund të pranoj bashkëpunimin më atë person i cili në procedurën penale njihet si dëshmitar bashkëpunues. Një çështje mjaft më rëndësi në procedurën penale është edhe trajtimi i dëshmitarëve dhe të dëmtuarve që kanë nevojë për mbrojtje për shkak të kanosjes së rrezikut serioz për atë dëshmitar apo familjen e tij dhe në këto raste paraqitet nevoja e ndërmarrjes së veprimeve nga të gjitha institucionet e implikuara në procedurën penale siç janë polica, prokuroria dhe gjykata. Çdo dëshmitar është i detyruar që ti përgjigjet ftesës për të dhënë dëshmi përveç nëse më ligj është paraparë ndryshe, por nëse pa arsye dhe në kundërshtim më ligjin personi nuk i përgjigjet thirrjes apo refuzon që të dëshmojë atëherë pasojnë masat dhe sanksionet ndaj dëshmitarit. Përmes këtij moduli synohet që pjesëmarrësit të mësojnë për llojet e dëshmitarëve, dallimin në mes tyre, mbrojtjen e dëshmitarëve, për mënyrat e intervistimit të dëshmitarëve, përpilimin e procesverbaleve për intervistimin e dëshmitarëve si dhe për rastet kur dëshmia e dëshmitarit konsiderohet si provë e papranueshme në procedurën penale. Gjithashtu një pjesë e këtij moduli do ti kushtohet edhe të dëmtuarit i cili mund të jetë jo vetëm palë në procedurë por edhe dëshmitar. Në këtë modul do ti kushtohet një vëmendje të drejtave të të dëmtuarit siç është e drejta në kompensimin e dëmit dhe shumë të drejta tjera që janë parashikuar më Kodin e ri të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Ky modul është bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të cilat dispozita janë përshtatur për këtë modul dhe të cilat do të shpjegohen duke u dhënë sqarime dhe interpretime bazuar në praktikën gjyqësore. Gjatë prezantimit të këtij moduli qasja do të jetë interaktive, duke u dhënë mundësi pjesëmarrësve që të paraqesin dhe diskutojnë të gjitha dilemat që kanë në praktikë dhe për të nxjerr konkluzione dhe rekomandime për tejkalimin e këtyre dilemave. Pjesëmarrësve do tu mundësohet qasja në raste praktike të përgatitura, ku mund të shihen sukseset dhe dështimet në rastin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të dëmtuarve, si dhe në rastet e dëshmitarëve bashkëpunues e gjithashtu do të realizohet edhe një simulim gjykimi me temën marrja në pyetje e dëshmitarit.

Kohëzgjatja: 9 sesione trajnimi (21 orë trajnimi).

9.3.11 Procesverbalet

Gjatë prezantimi të këtij moduli do të paraqiten njohuritë themelore për të kuptuar se çfarë janë procesverbalet, kush janë personat që ushtrojnë veprimet gjatë procedurës penale, përkatësisht personat kompetent që shënojnë veprimet në procesverbal, si krijohen procesverbalet, si mbahen, si shkruhen dhe ruhen ato, shënimet që duhet të përmbajnë procesverbalet, për rëndësinë e shqyrtimit të tyre dhe të drejtat e palëve që deklarojnë. Ky modul trajton, punën që bëhet në organet policore, prokuroriale dhe gjyqësore lidhur me procesverbalet, si veprime të rëndësishme në të gjitha fazat e procedurës penale. Prezantimi do t'u ofrojë mundësi pjesëmarrësve të mësojnë mënyrën e marrjes së procesverbaleve, regjistrimin e seancave me incizim audio dhe me incizim audio dhe video, regjistrimin e veprimeve me incizim audio ose incizim audio dhe video, stenografimin dhe transkriptimin, stenografimin me dorë apo me makinë dhe transkriptimi, incizimin nga të tjerët, për përmbajtjen dhe mbajtjen e shkresave të lëndës, përfshirë procesverbalet. Po ashtu, qëllimi i këtij moduli është që pjesëmarrësit të njoftohen me punën e prokurorit të shtetit dhe gjykatës. Në këtë modul pjesa e ushtrimeve do të zbatohet duke i ofruar pjesëmarrësve shembuj nga praktika, përkitazi me përpilimin e procesverbaleve në faza të ndryshme të procedurës, në mënyrë që ata të jenë në gjendje t'i radhisin procesverbalet sipas organeve kompetente që i ndërmarrin, sipas radhës dhe rëndësisë së tyre dhe nëpërmes diskutimeve të identifikojnë statusin e secilës palë që jep deklaratë në cilëndo fazë të procedurës në mënyrë që të kuptojnë, krahasojnë dhe të vlerësojnë domosdoshmërinë e marrjes së tyre.

Kohëzgjatja: 3 sesione trajnimi (9 orë trajnimi).

9.3.12 Procedurat alternative

Procedurat alternative janë të rëndësishme për faktin se janë të parapara me legjislacionin bashkëkohor dhe me rastin e zgjidhjes së tyre u mundësojnë palëve në procedurë të jenë të kyçura drejtpërdrejt në aplikimin e tyre dhe në këtë mënyrë eviton procedurat e stërzgjatura përmes procedurës së rregullt gjyqësore. Trajtimi i këtij moduli për prokurorët fillestar do të jetë mjaft i dobishëm gjatë punës së tyre, meqë përmes aplikimit të procedurave alternative do të rritet produktiviteti i performacës së tyre e gjithashtu do të jetë i dobishëm për palët në procedurë me qëllim të zgjidhjes së rasteve të tyre në kohë sa më të shpejtë të mundshme. Prokurorët kanë një rol të rëndësishëm përkitazi me marrjen e vendimeve përfundimtare përkitazi me marrëveshjet e palëve në procedurë. Në këtë modul do të trajtohet: pezullimi i përkohshëm i procedurës (neni 320) provat sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe diversioni, kushtet kur ndjekja nuk është e detyrueshme (neni 228), procedura e ndërmjetësisimit, negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë (Neni 230), dëshmitarët bashkëpunues dhe procedura për shpalljen e personit dëshmitar bashkëpunues. Pjesëmarrësve do tu mundësohet qasja në raste praktike të përgatitura, ku mund të shihen sukseset dhe dështimet sa i përket procedurave alternative.

Kohëzgjatja: 6 sesione trajnuese (18 orë trajnimi).

9.3.13 Administrimi i procedurës penale

Duke pasur parasysh rëndësinë e temave që do të zhvillohen në këtë modul, kohën e caktuar për prezantim dhe me cilat vështirësi më së shumti ballafaqohen gjykatat dhe prokuroritë në punën e tyre për temat që do të shtjellohen gjatë trajnimit, gjatë prezantimit të këtij moduli do të synohet që pjesëmarrësit të njoftohen, sa më afër dhe të qartësohen sa më shumë që është e mundur këto tema të këtij kapitulli të KPPK-së. Përmbajtja e këtij moduli do të përqendrohet tek parashtrësat, afatet, dërgimi i shkresave, marrja dhe komunikimi i vendimeve kapitulli XXVI dhe XXVII përfshirë qasjen me aktakuzë dhe publikimin e vendime, ekzekutimi i vendimeve dhe shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesa pasurore juridike. Pjesëmarrësve do tu mundësohet qasja në raste praktike të përgatitura, ku mund të shihen sukseset dhe dështimet në rastin e administrimit të procedurës penale.

Kohëzgjatja: 4 sesione trajnues (12 orë trajnimi).

9.3.14 Provat gjatë hetimit

Për rrjedhojë, rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe fajësia e të pandehurit mund të përcaktohen vetëm me anë të provave. Për tu shqiptuar një vendim i drejtë dhe ligjor në procedurë penale procesi i të provuarit (argumentimit) në drejtim të vërtetimit të fakteve relevante juridike në një çështje penale është shumë i rëndësishëm. Andaj pjesë e këtij moduli është në përgjithësi procesi i të provuarit gjatë fazës së hetimeve, roli i provave në procedurë në ndriçimin e një çështje penale, subjektet proceduralë të cilët mund të mbledhin dhe sigurojnë prova në këtë fazë të procedurës, provat e papranueshme. Pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të njoftohen me provat- përkufizimi, sigurimi i provave në veprimet fillestare të policisë, sigurimi i provave me anë të masave të veçanta të hetimit, provat në fazën e hetimeve, bastisja – kontrolli -sekuestrimi i përkohshëm dhe ekspertizat, marrja e provave gjatë hetimeve deklarimi i të pandehurit dhe dëshmia e dëshmitarit dhe provat e papranueshme. Gjithashtu në kuadër të këtij moduli do të realizohet një gjykim rreth provave të pa papranueshme.

Kohëzgjatja: 9 sesione trajnimi (27 orë trajnimi).

9.3.15 Aktakuza dhe procedura e shqyrtimi

Aktakuza është njeri ndër aktet akuzuese të cilën sipas autorizimit e paraqet prokurori i shtetit, pas fazës së hetimeve ose drejtpërdrejt, kundër kryerësve të veprave penale për veprat penale të cilat sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, janë të përcaktuara si vepra penale. Rëndësia e aktit akuzues qëndron në faktin se e vënë në lëvizje procedurën penale ndaj kryerësve të veprave penale dhe i hapë rrugën gjykatës që ti sanksionoj kryerësit e veprave penale. Moduli do të trajtoj Aktakuza, llojet dhe përmbajtja, procedura e ngritjes së aktakuzës, të drejtat e të pandehurit pas ngritjes së aktakuzës, ndryshimi, zgjerimi dhe huthja e aktakuzës, propozimet ndaj kryesve të veprave penale me çrregullime mendore nën ndikim të alkoolit dhe drogës. Përmes këtij moduli, sidomos me pjesën praktike synojmë të arrijmë përgatitjen e prokurorëve të shtetit të sapoemëruar, në mënyrë që të njëjtit mos të kenë pengesa dhe paqartësi në hartimin dhe prezantimin e akteve akuzuese gjatë punës së tyre.

Kohëzgjatja: 7 sesione trajnimi (21 orë trajnimi).

9.3.16 Roli i prokurorit në fazat e shqyrtimi gjyqësor

Jurisprudenca e gjykatave vendore dhe ndërkombëtare ka vërtetuar se të qenit prokuror është përgjegjësi e madhe sepse puna e prokurorit afekton shumë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me kushtetutë dhe kornizën ligjore vendor dhe ndërkombëtare. Moduli synon të trajtoj Rolin e prokurorit të shtetit në procedurë gjatë shqyrtimit fillestar, rolin e prokurorit në shqyrtimin gjyqësor, fjala hyrëse e prokurorit, marrja e drejtpërdrejtë dhe e tërthorët në pyetje, paraqitja e provave dhe roli i prokurorit në fjalën përfundimtare përfshirë deklarin mbi dënimin.

Kohëzgjatja: 7 sesione trajnimi (21 orë trajnimi).

9.3.17 Shqyrtimi fillestar dhe shqyrtimi gjyqësor

Shqyrtimi gjyqësor konsiderohet faza më e rëndësishme e procedurës penale dhe për këtë arsye shqyrtimit gjyqësor i kushtohet një rëndësi e veçantë edhe me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejshëm KPP). Shqyrtimi gjyqësor përbëhet prej disa fazave dhe e gjithë veprimtaria e shqyrtimit gjyqësor përmbledhet në: fillimin e shqyrtimit gjyqësor dhe deklarin e të akuzuarit; prezantimin (paraqitja) e provave dhe fjalën përfundimtare të palëve. Mirëpo, duhet theksuar se nëse i akuzuari e pranon fajësinë, atëherë pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor dhe deklarin e të akuzuarit, kalohet menjëherë në fjalën përfundimtare të palëve. Moduli trajton

shqyrtimin fillestar, marrëveshja për pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar dhe shqiptimi i dënimit, kundërshtimi i provave, shqyrtimi gjyqësor, rrjedha e shqyrtimit gjyqësor. Gjithashtu në kuadër të këtij moduli do të realizohet një simulim gjykimi.

Kohëzgjatja: 8 sesione trajnimi (24 orë trajnimi).

9.3.18 Procedurat e veçanta sipas KPPK

Procedurat e veçanta sipas Kodit të Procedurës Penale dallojnë nga procedurat e rregullta në procedurën penale, prandaj si të tilla kërkojnë një vëmendje shtesë për profesionistët që aplikojnë këto procedura, veçanërisht për prokurorët e sapoemëruar. Ky modul do të trajtoj procedurat që kanë të bëjnë me dhënien e urdhrit ndëshkimor, shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, ndaj personave që kanë kryer vepër penale nën ndikimin e alkoolit ose të drogës, për kryerësit me çrregullime mendore, revokimin e dënimeve alternative, vendimin për shlyerjen nga evidenca e të dënuarve, kompensimin e dëmit, rehabilitimin, dhe ushtrimin e të drejtave tjera të personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye, dhe procedurën për dhënien e letërreshtimit dhe të shpalljeve publike.

Kohëzgjatja: 3 sesione trajnimi (9 orë trajnimi).

9.3.19 Ushtrimi i mjeteve juridike

Kodi i procedurës penale në kapitullin XXI ka përcaktuar llojet e mjeteve juridike të cilat mund të përdoren nga palët në procedurë, për të ankimuar një vendim gjyqësor. Në nenin 274 të KPP-së, janë paraparë katër (4) kategori të mjeteve juridike të cilat palët në procedurë mund ti paraqesin ndaj vendimeve gjyqësore. Kodi i procedurës penale parasheh që palët e pakënaqura me vendimet gjyqësore në procedurë penale, kanë të drejtë nën kushtet e caktuara që të përdorin mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike. Qëllimi i përdorimit të mjeteve juridike është evitimi i të metave juridike dhe faktike që pretendohet se janë bërë nga gjykata përkatëse. Gjatë këtij trajnimi do të përdoren bashkëbisedim aktiv me pjesëmarrësit lidhur me çështje dhe dilema nga praktika gjyqësore, duke mos e lënë anash diskutimin e situatave të ndryshme para të cilave do të gjendeshin gjyqtarët dhe prokurorët në vendosjen e rasteve lidhur me mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike. Në këtë modul do të trajtohen: ushtrimi i mjeteve juridike nga e prokurorit, ankesa kundër aktvendimeve dhe kundërshtimet, bazat e parashtrimit të ankesës, dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike. Gjithashtu do të diskutohet edhe për përpilimin e ankesave nga prokurori i shtetit për shkak të shkeljes së ligjit penal, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, shpenzimeve të procedurës penale, dhe kërkesave pasurore.

Kohëzgjatja: 6 sesione trajnimi (18 orë trajnimi).

9.4 Shkathtësitë personale dhe nderperesonale

9.4.1 Rregullat e komunikimit

Komunikimi në përgjithësi është shkathtësi dhe atribut ontologjik e etiko - social i qenjeve njerëzore. Zhvillimi i hovshëm shoqëror-ekonomik, tekniko teknologjik është përcjellur edhe me standardizime në komunikim herë duke i ruajtur finesat nacionale, etnike kulturore e subkultura e herë- herë duke i sinkronizuar ato në standardizime të institucionalizuar në fusha përkatëse, e sidomos në fushën e teknologjisë e informatikës dhe në fushën juridike. Profesionit i juristit e sidomos ai i prokurorit si të ne në Kosovë, ashtu edhe më gjerë kërkon po ashtu si profesionet tjera, një zhvillim të komunikimit cilësor, delikat e konsekuent normativ e profesional brenda vet institucionit të gjykatës si dhe jashtë institucionit me strukturat tjera institucionale dhe opinionin publik në përgjithësi. Përveç përgatitjes profesionale të mjaftuar kualifikuese, edukimi dhe përgatitja e gjyqtarëve bashkëkohor sot nënkupton edhe trajnimin e tyre dhe zhvillimin e

shkathësive komunikuese. Ky nën modul do fokusohet tek shkathësitë komunikuese brenda rregullave të brendshme, pra zhvillimi i shkathësive për komunikim të brendshëm duke i mësuar e përvetësuar rregullat e brendshme të komunikimit brenda vet institucionit të gjykatës në vijën vertikale subordinuese dhe atë horizontale bashkëpunuese dhe zhvillimi i shkathësive për komunikim me jashtë, përkatësisht komunikim me struktura, institucione tjera si dhe opinionin publik në tërësi. Ky modul do të trajtoj: Baza e komunikimit, dhe llojet e tij, veçoritë e komunikimit verbal dhe jo verbal, dallimet dhe lidhjet midis komunikimit verbal dhe jo verbal, komunikimi interpersonal, personal dhe apersonal, të dëgjuarit dhe të folurit, shkathësia e dëgjimit aktiv, problemet në komunikimin interpersonal dhe rregullat e komunikimit të mirë.

Kohëzgjatja: 2 sesione trajnuese (6 orë trajnimi).

9.4.2 Etika profesionale dhe përgjegjësia disiplinore

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji nr. 06/L – 057), ka përcaktuar shkeljet disiplinore, procedurat për fillimin e hetimeve për dyshimet për shkelje disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, procedurat disiplinore pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, sanksionet disiplinore dhe mjetet juridike që lidhen me shkeljet disiplinore pranë Gjykatës Supreme. Ky ligj është ndërtuar në bazë të parimeve e që janë parimi i ligjshmërisë, respektimit të pavarësisë së gjyqësorit, gjykimit të drejtë, proporcionalitetit, transparencës, dhe llogaridhënies. Përkatësisht me këtë ligj janë paraparë kushtet ligjore dhe procedurale për fillimin dhe zhvillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, caktimin i shkeljeve disiplinore, llojet e tyre, kohëzgjatja masave disiplinore procedura dhe organet që i shqiptojnë masat disiplinore. Kjo ka rëndësi të veçantë për faktin se gjyqtarët dhe prokurorët janë të obliguar që gjatë punës së tyre të sjellën konform rregullave që i përmban ky ligj.

Trajnimi duhet të fokusohet në trajtimin e rasteve konkrete dhe kriterëve të cilat duhet të merren parasysh me rastin e fillimit të procedurës disiplinore, cilat janë ato shkelje disiplinore e që bien ndesh me ligjin për përgjegjësinë disiplinore, fazën e propozimit për fillimin e kësaj procedure, lloji i masave të propozuara, fazën e procedurës në organet vendimmarrëse, të drejtat e subjektit, në këtë rast gjyqtarit apo prokurorit dhe fazën e mjetit juridik. Ky modul do të adresoj çështjet dhe dilemat të cilat janë shfaqur në punën e përditshme duke analizuar dhe prezantuar me saktësi standardet më të mira procedurale me rastin e propozimit për shkelje disiplinore nga ana e prokurorit të shtetit në një rast të caktuar. Moduli do të trajtojë: Kodi i Etikës dhe sjelljes profesionale për Prokurorë, Integriteti i prokurori, llogaridhënia dhe transparenca, standardet ndërkombëtare mbi etiken e prokurorit, përfshirë raste nga praktika ndërkombëtare, procedura disiplinore ndaj prokurorëve dhe masat disiplinore.

Si pjesë e trajnimit duhet të diskutohen dispozitat ligjore përkatëse dhe prezentohen praktikat më të mira lidhur me kushtet ligjore dhe situatat praktike, të cilat duhet ti ketë parasysh prokurori i shtetit si dhe autoriteti kompetent me rastin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore si dhe shqiptimin e masave.

Kohëzgjatja: 8 sesione trajnuese apo 24 orë trajnimi.

9.4.3 Menaxhimi i rasteve dhe vlerësimi i performancës së prokurorëve

Menaxhimi është proces i planifikuar i aktiviteteve për arritjen e qëllimeve të caktuara në lëmi përkatëse. Nga ky definicion i thjesht shihet se sa është i rëndësishëm ky proces për prokurorit në tërësi dhe për prokurorët në veçanti. Teoria moderne për menaxhim të rasteve është që prokurori, s'bashku me stafin mbështetës, duhet që në mënyrë aktive të monitorojnë dhe kontrollojnë lëvizjen e lëndëve të pakryera në prokurori. Procesi i vlerësimit të performancës në baza të rregullta është jetik për çdo organizatë apo institucion. Qëllimi i vlerësimit të performancës së prokurorëve është vlerësimi i kompetencës profesionale dhe performancës së prokurorëve, si dhe përmirësimi i performancës, profesionalizmit, integritetit, llogaridhënies dhe efikasitetit të sistemit prokurorial.

Pra, në thelb, qëllimi i vlerësimit të përformancës është që të mbështetet dhe përmirësohet përforma e prokurorëve, duke identifikuar mangësitë e pengesat dhe pastaj duke ndërmarrë hapat e nevojshëm për t'i eliminuar ato. Një proces i mirëfilltë i vlerësimit të përformancës i shërben edhe qëllimit të forcimit të kulturës institucionale dhe ndikon në përmirësimin e përformancës së individit. Ky proces u jep mundësinë të vlerësuarve që të kuptojnë më mirë së ç 'pritet nga ta, ndërkaq eprorëve u jep mundësinë të kuptojnë më mirë shkathtësitë dhe motivet e vartësve të tyre, duke bërë të mundur për të dyja palët që të zhvillohen së bashku dhe të arrijnë synimet e përbashkëta. Natyrisht, vlerësimet duhet të jenë të personalizuar dhe të përshtatura ashtu që të reflektojnë punën, të arriturat dhe mangësitë e mundshme të secilit të vlerësuar, si dhe pritjet e institucionit dhe eprorit për periudhën që vijon.

Në kuadër të këtij modul do të trajtohet: Menaxhimi i rasteve dhe karakteristikat e tij, planifikimi si funksion kryesor i menaxhimit të rasteve nga ana e prokurorit, SMIL-i në funksion të menaxhimit, matja e përformancës së prokurorit dhe kriteret për matjen e performances.

Kohëzgjatja: 9 sesione trajnimi (27 orë trajnimi).

9.4.4 Ngritja e shkathtësive sociale të prokurorëve dhe menaxhimi i stresit

Nevoja për një kompletim fleksibil e cilësor të prokurorëve të rinjë, rezultojë me futjen në programin e trajnimit fillestar edhe nën moduleve me karakter interdisiplinar përmes të cilëve prokurorët e sapo emëruar do të kenë mundësi të njihen me nocione e kategori, përmbajtje e informacione tjera të rëndësishme nga fusha sociale e psikologjike. Ky nën modul ka për qëllim ngritjen e shkathtësive sociale të prokurorëve dhe pajisjen e tyre me njohuri themelore psiko-sociale, komponentë kjo e rëndësishme e kompletimit të një gjyqtari bashkëkohor i cili krahas vëllimit të njohurive dhe eksperiencave profesionale nga lëmia e drejtësisë, me këto njohuri, informata dhe eksperiencia të reja nga fusha sociale psikologjike avancohet për një performancë më cilësore gjatë ushtrimit të detyrës shumë të rëndësishme e tejet delikat. Diversiteti struktural tematik i këtij nën moduli si p.sh. temat për individin dhe sociumin, mëdhenjtë sociale të individin me të tjerët, motivet, konfliktet, stresi dhe menaxhimi i tij etj, ofrojnë spektër të gjerë të informatave nga fusha e gjerë sociologjike e psikologjike të nevojshme për një prokuror të sapo emëruar. Ky nën modul trajton tema si : Individu dhe mjedisi social, konfliktet, ngritja e shkathtësive sociale predispozite e avancimit të performancës profesionale, motivimi, stresi dhe shëndeti trupor, psikologjia sociale dhe kriminaliteti, burimet psikosociale të kriminalitetit, dhe kriminaliteti si dukuri sociale.

Kohëzgjatja: 4 sesione trajnuese apo (12 orë trajnimi).

9.4.5 Shkrimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore (akteve akuzuese/ankesave)

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, në kapitujt XV, XX dhe XXI, ka përcaktuar formën dhe përmbajtjen e vendimeve, kërkesave, akteve akuzuese si dhe mjeteve juridike dhe të gjitha shkresave e që janë pjesë e procedurës penale. Përkatësisht, duke filluar nga kërkesat e thjeshta, kërkesat për masat, aktvendimi për fillim të hetimeve e deri tek mjetet juridike, janë paraparë kushtet ligjore dhe arsyetimi i akteve procedurale. Kjo ka rëndësi të veçantë për faktin se nga përmbajtja e akteve dhe arsyetimi i vendimeve varet interpretimi i drejtë i dispozitave ligjore e që ne jemi të obliguar që të ju përmbahemi në mënyrë që mos të vijmë tek shkeljet procedurale që për pasojë do të kishin zhvillimin e procedurës. Gjithashtu, është me rëndësi që në rastet kur përpilohen vendimet gjyqësore apo edhe aktet e prokurorisë, prokurori i shtetit duhet që propozimet e veta në aktin akuzues të jenë të arsyetuara mirë në mënyrë që gjykata ti ketë në konsideratë me rastin e marrjes së vendimit përfundimtar. Ky modul do të adresoj çështjet dhe dilemat të cilat janë duke u shfaqur në punën e përditshme të prokurorit të shtetit, duke analizuar dhe prezantuar me saktësi standardet më të mira të shkrimit ligjor dhe arsyetimit me rastin e marrjes së vendimeve procedurale dhe me rastin e paraqitjes së kërkesave procedurale nga ana e prokurorit të shtetit në një rast penale apo edhe mjeteve juridike. Trajnimi duhet të fokusohet në

trajtimin e strukturës dhe përmbajtjes së arsytimit të akteve akuzuese, dispozitat relevante ligjore procedurale për përpilimin e akteve sipas KPP dhe detyrimet për arsytimin e akteve sipas KPP. Si pjesë e trajnimit duhet të diskutohen dispozitat ligjore përkatëse dhe prezantohen praktikat më të mira ndërkombëtare, të cilat duhet ti ketë parasysh prokurori i shtetit me rastin e përpilimit dhe arsytimit të vendimeve.

Kohëzgjatja: 6 sesione trajnimi (18 orë trajnimi)

9.5 Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësues

9.5.1 Kodi i drejtësisë për të mitur

Kodi i Drejtësisë për të mitur ka rregulluar veprimet ndaj të miturit si kryes i veprës penale, fëmijët e përfshirë dhe të miturit si pjesëmarrës në procedurë, organeve të cilat zbatojnë procedurën penale ndaj të miturve, ekzekutimin e masave dhe dënimeve ndaj kryesit të mitur të veprës penale, si dhe mbrojtjen e personave të mitur dhe fëmijëve të cilët janë viktimë dhe të dëmtuar nga vepra penale. Për ta bërë më të qartë Kodi i Drejtësisë për të mitur rregullon tërë procedurën penale kur janë të përfshirë të miturit si dhe pjesën e përgjithshme të ligjit material e cila ka të bëjë me masat dhe dënimet e parapara për të miturit si kryes të veprave penale si dhe pjesën e ekzekutimit të këtyre masave. Kodit të drejtësisë për të mitur ka rëndësi e veçantë edhe për faktin se në kryerjen e shumë veprave penale, duke filluar nga ato më të lehtat e deri në veprat penale më të rënda, janë të përfshirë personat e mitur qoftë si kryes individual, së bashku me të mitur të tjerë por edhe me personat madhorë. Gjithashtu, është me rëndësi që në rastet kur veprat penale kryhen së bashku me personat madhorë, prokurori duhet që të ketë njohuri se kur mundet që të bashkohet procedura apo edhe kur mundet që procedura penale të zhvillohet veçmas. Ky modul do të adresojë çështjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me Kodin e Drejtësisë për të mitur dhe dilemat të cilat shfaqen në punën e përditshme të prokurorëve gjatë zbatimit të këtij kodi, duke analizuar dhe prezantuar me saktësi standardet më të mira procedurale, interesin më të mirë për të miturin me rastin e propozimit të masave apo edhe dënimeve. Trajnimi duhet të fokusohet në trajtimin e kriterëve të cilat duhet të merren parasysh me rastin e fillimit të procedurës penale apo procedurës përgatitore, mundësitë e shqiptimit të masave para fillimit të procedurës përgatitore, fazën e propozimit për masat edukative, fazën gjyqimit dhe fazën e mjetit juridik. Gjithashtu do të diskutohen dispozitat ligjore përkatëse që e karakterizojnë procedurën penale ndaj të miturit, rolin e prokurorit në procedurën për të mitur dhe prezantohen praktikat më të mira lidhur me kushtet ligjore dhe situatat praktike, të cilat duhet ti ketë parasysh prokurori për të mitur me rastin kur në është i përfshirë i mituri në një procedurë penale e deri në përfundim të saj.

Kohëzgjatja: 2 sesione trajnuese (6 orë trajnimi)

9.5.2 Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore

Ky modul zbatohet me metodologjinë e bazuar në raste ku prokurorët ka mundësi të zhvillojnë shkathtësitë e tyre në marrjen në pyetje dhe udhëheqjen e shqyrtimit gjyqësor. Në mënyrë specifike ngritja e shkathtësive do bëhet për fjalën hyrëse, marrjen e drejtpërdrejtë dhe të tërthorët në pyetje, vënien në dyshim, rehabilitimin dhe fjalën përfundimtare. Gjithashtu në kuadër të këtij moduli realizohet edhe një simulim gjyqimi.

Kohëzgjatja: 8 sesione trajnues (24 orë trajnimi)

9.5.3 Ligji për kundërvajtje

Duke pasur parasysh që vepra e kundërvajtjes është vepër që kryhet në shumë lëmi, rëndësinë e tyre, kohën e kufizuar për trajnim, gjatë këtij sesi do të synohet që pjesëmarrësit të njoftohen me veprën e kundërvajtjes, dallimin me veprat e tjera, parimet e veprës dhe përcaktueshmërinë e veprës kundërvajtëse me dispozitat ligjore në fuqi. Pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të njoftohen me

veprën e kundërvajtjes, çka e dallon nga veprat tjera, dhe cilat janë elementet e përbashkëta me veprat tjera (vepra penale, delikti ekonomik etj.). Gjithashtu pjesëmarrësit do të njoftohen me parimin e ligjshmërisë, dhe rëndësinë e tij në përkufizimin e veprës së kundërvajtjes si dhe organet për paraqitje të kërkesës për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes.

Kohëzgjatja: 2 sesion trajnimi (6 orë trajnimi)

9.5.4 Dhuna në familje

Kodi Penal i Republikës së Kosovës në kapitullin e XXI të veprat penale kundër Martesës dhe Familjes në nenin 248 ka përcaktuar veprën penale Dhuna në Familje, elementet e kësaj vepre penale janë në përputhje me Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore- “dhuna në familje” - nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike që ndodhin brenda marrëdhënies në familje, ose njësisë shtëpiake, pavarësisht nga lidhja e gjakut apo marrëdhënies familjare, ose nga ish- partneri intim ose partneri intim aktual, pavarësisht nga fakti nëse ushtruesi i dhunës ndan apo ka ndarë të njëjtin banim me viktimën me qëllim të cenimit të dinjitetit dhe mbajtjes nën kontroll të vazhdueshëm dhe pozitë varësie, personat ndaj të cilëve është ushtruar dhuna. Nisur nga rëndësia që ka trajtimi i këtij fenomeni kompleks, Kosova në vitin 2020 me Amendament Kushtetues ka pranuar si pjesë të sistemit juridik të vendit Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, e njohur si Konventa e Stambollit e cila bazohet në katër shtylla kryesore: parandalimi, mbrojtja, ndjekja penale dhe politikat e bashkërenduara. Në frymën e kësaj konvente në vitin 2023 është miratuar Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore (Ligji Nr. 08/L-185 21 shtator 2023), me qëllim që të parandalojë dhe trajtojë dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhuna në baza gjimore, të mbrojë dhe të kontribuojë në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, promovimin e barazisë gjimore dhe fuqizimin e grave si dhe të ndërtojë mekanizmat e nevojshëm për ofrimin e mbështetjes ndaj viktimave të të gjitha formave të dhunës të rregulluara me këtë ligj. Në kuadër të modulit dhuna në familje” do të shtjellohet kuptimit dhe përkufizimi i dhunës në familje, dhuna ndaj grave, dhunë me bazë gjimore ndaj grave, ngacmimi politik, dhuna politike, dhunë psikologjike, dhuna ekonomike, kontrolli i vazhdueshëm, ngacmimi seksual përmes internetit, sindromi i personit të dhunuar dhe përkufizimin palëve dhe përfaqësuesit për mbrojtjen e interesave të viktimave.

Në përmbajtje të këtij moduli dhe gjatë trajnimit do të synohet që pjesëmarrësit të njoftohen me tema që kanë të bëjnë me hetimin, ndjekjen penale, gjykimin dhe politiken ndëshkimore, lidhur me veprën penale dhuna në familje dhe ligjin Ligji Nr. 08/L-185. do të arrijnë të kuptojnë subjektet që kanë të drejtë për të iniciuar procedurën për shqiptimin e masave mbrojtëse, masat mbrojtëse marrë për bazë dhunën në familje, dhunën ndaj gruas dhe formave të tjera të dhunës të rregulluar me këtë ligj, procedura për shqyrtimin e kërkesës për urdhër mbrojtje të rregullt dhe procedura për shqyrtimin e kërkesës për urdhër mbrojtje emergjente. Rëndësia e këtij moduli qëndron në të kuptuarit e elementeve të veprës penale dhuna në familje dhe rasteve kur vepra tjera penale të përcaktuara në kodin penal, kryhen brenda marrëdhënies familjare, e që sipas kodit penal konsiderohen rrethana rënduese. Gjithashtu për prokurorët e riijnë arritjen e një standardi unik të hetimit dhe ndjekjes penale, si në kuptim të ndërmarrjes së veprimeve procedurale dhe hetimore, ashtu edhe në kuptim të vlerësimit dhe analizimit të provave personale e materiale, pretendimeve faktike dhe cilësimit juridik.

Kohëzgjatja: 2 sesione trajnimi (6 orë trajnimi)

9.5.5 Mbrojtja nga diskriminimit

Moduli “*Mbrojtja nga diskriminimit*” është dizajnuar në mënyrë të tillë që përfshinë trajtimin në mënyrë bashkëkohore të parimeve dhe procedurave për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë. Meqenëse numri i rasteve të iniciuara në gjykatë me bazë mbrojtjen kundër diskriminimit është në rritje e sipër, atëherë kjo edhe e përcakton nevojën e përfshirjes së këtij moduli në kurrikulën e programit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar. Moduli përmban çështjet ma thelbësore rreth bazave dhe formave të manifestimit të diskriminimit, llojet e trajtimit të pabarabartë, detyrimet e institucioneve publike në parandalimin dhe trajtimin e rasteve kundër diskriminimit, si dhe procedurat, afatet dhe vendimmarrja nga ana e gjykatës për trajtimin e padive me bazë diskriminimin. Ky modul është dizajnuar që të paraqes edhe mënyrën se si duhet të zbatohen dispozita e Ligjit kundër Diskriminimit (LMND) në praktikë, përmes trajtimit të rasteve praktike, të cila mbështetën në praktikën gjyqësore të gjykatave vendore dhe asaj të GJEDNJ, bazuar në interpretimin e nenit 14 të KEDNJ, për mbrojtje kundër diskriminimit. Moduli “*Mbrojtja nga diskriminimit*”, prezantohet duke u referuar vazhdimisht në praktikë, lidhur me sfidat e zbatimit unik të Ligjit për Mbrojtje kundër Diskriminimit, si garancion i ligjshmërisë së procesit për të drejtat e palëve dhe mbrojtjen e tyre ndaj veprimeve diskriminuese. Ky modul është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike. Moduli do të trajtoj: Bazat dhe format e manifestimit të diskriminimit sipas LMND, Llojet e Trajtimit të Pabarabartë, Përgjegjësitë e Institucioneve të Republikës së Kosovës, Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe procedura para tij, Procedura para gjykatës, Afatet, Barra e Provave, Shqyrtimi i fakteve nga gjykata në lidhje me të provuarit e diskriminimit, llojet e vendimeve dhe mjetet juridike, Shpërblimi i dëmit për shkak të diskriminimit nga marrëdhënia e punës, E Drejta Materiale për Ndalimin e Diskriminimit, Instrumentet Ndërkombëtare të cilat janë të Zbatueshme në Kosovë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Interpretimi i Nenit 14 i KEDNJ nga GJEDNJ, Praktika GJEDNJ e aplikueshme sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kohëzgjatja: 2 sesione trajnuese (6 orë trajnimi).

10. Përfundim

Programi trajnues fillestar për prokurorët e sapo emëruar përfaqëson një fazë themelore në procesin e profesionalizimit të tyre dhe në forcimin e integritetit të sistemit të drejtësisë. Përmes ndërthurjes së përmbajtjes teorike me ushtrimet praktike, ky program siguron që prokurorët të pajisen me kompetencat e nevojshme ligjore, procedurale dhe etike për të ushtruar me përgjegjësi dhe paanshmëri funksionin e tyre. Përfundimi i suksesshëm i këtij trajnimi garanton jo vetëm ndërtimin e një baze të fortë njohurish dhe aftësish profesionale, por edhe orientimin e prokurorëve të rinj drejt zhvillimit të vazhdueshëm, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të shtetit të së drejtës. Në këtë mënyrë, trajnimi fillestar nuk është vetëm një kusht hyrës në profesion, por një investim strategjik për krijimin e një prokurorie të pavarur, të besueshme dhe të përkushtuar ndaj mbrojtjes së interesit publik dhe të drejtave të njeriut. Struktura e programit, modulet trajnuese dhe trajnimi praktik, reflektojnë synimet e përcaktuara të AD-së për zhvillim të kompetencave, duke u mbështetur në kohëzgjatjen e trajnimit të përcaktuar me ligj dhe duke marrë në konsideratë përgatitjen dhe përvojën e kaluar profesionale të përfituesve të cilët tashmë kanë kaluar të gjitha fazat e testimit dhe vlerësimit të kompetencave profesionale nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përkatësisht komisioneve përkatëse.